



Certifikimi me GlobalG.A.P, mundësi për rritjen e vlerës të produkteve të eksportuara

Faqe 4



Valentina Postoli, përfaqësuesja e KASH-it, anëtare e Bordit të Ushqimit

Faqe 5



KASH adreson kërkesat për zgjidhjen e problemeve që ndesh blegtoria sot

Faqe 2



AGROBIZNESI



Rr. "Qemal Stafa", P. 9-katësh, Nr. 70, Kati 2, Pazari i ri, Tiranë.
Tel: +355 4 2 251 910 /911
Email: info@fedinvest.al
kontakt@fedinvest.al
www.fedinvest.al

BOTIM I KËSHILLIT TË AGROBIZNESIT SHQIPTAR

Adresa: Rruga "Mine Peza", Pallati 87/3, Hyrja 1, Kati i parë, Tel/ Fax: 2229445
E-mail: infokash@yahoo.com www.kash.org.al

15-ditëshi i parë i muajit janar 2022

Viti i shtatëmbëdhjetë i botimit - Nr. 429
Çmimi 125 lekë

E përdyjavshme e pavarur

PROBLEMET DHE ÇËSHTJET QË SHQETËSOJNË BKFSH-NË

BASHKIMI KOMBËTAR I FERMERËVE LETËR TË HAPUR KRYEMINISTRIT EDI RAMA PËR HEQJEN E RIMBURSIMIT TË TVSH-SË PËR PRODHIMET BUJQËSORE, MBËSHTETJEN ME GRANTE PËR MEKANIKË, PËRMIRËSIMIN E SKEMËS SË SUBVENCIONEVE DHE RITJEN E INVESTIMEVE NË UJITJE E KULLIM

Gazeta "Agrobiznesi" zbardh kërkesat e fermerëve në katër drejtime kryesore: Kooperim dhe Koordinim; Mekanizim, Inovacion dhe Dixhitalizim; Financim, Disbursim i fondeve grant; Përmirësim i legjislacionit

RISI ALBANIA

Eksperti Rrapokushi: Prodhimet e certifikuara të sigurt në eksportin e tregjeve me vlerë të lartë



Një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC



Faqe 2



KASH KONTRIBUT NË HARTIMIN E REZOTUTËS PËR VRESHTARINË

Akademia e Shkencave të Shqipërisë dhe Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës rezolutë në simpoziumin shkencor "Vreshtaria dhe verëtaria në hapësirën mbarëshqiptare"

Faqe 3

Krifca: Skema e mbështetjes, fokus prodhimet në serra

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca zhvilloi një takim me fermerët e Lushnjës dhe më pas pa nga afër punën në ...



Faqe 5

INTERVISTË

Eksporte në tregje me vlerë të lartë - Fermerët përfitojnë nga certifikimi në grup me GlobalGAP



Faqe 4

DIXHITALIZIM DHE INOVACION

I kthyer nga emigracioni hap kompani teknologjike në Shqipëri

Faqe 6

KËNDI I EKSPERTIT

- KËSHILLA PËR FERMERËT QË MBARËSHTOJNË BAGËTI TË IMTA
- DOMOSDOSHMERIA E PËRDITËSIMIT TË KATEGORIVE TË TOKËS NË NJËSITË ADMINISTRATIVE


Faqe 11, 12

RISI ALBANIA

FORUM PËR BLEGTORINË

Prodhimet e certifikuara të sigurt në eksportin e tregjeve me vlerë të lartë

Certifikata GlobalGAP është një pasaportë besueshmërie për një produkt të pastër, pa mbetje toksikologjike



Andon Rrapokushi, Menaxher i Departamentit të Certifikimeve pranë Doni Fruits në një intervistë për Gazetën "Agrobiznesi", foli mbi rëndësinë e certifikimit të prodhimeve bujqësore me standardet që njeh tregu ndërkombëtar, teksa vuri në dukje se "prodhimet e certifikuara e kanë të sigurt tregun e eksportit".

"Prodhimet e certifikuara e kanë të sigurt tregun e eksportit, sepse certifikimi përkthehet në produkt të sigurt, që do të thotë zbatim rigoroz në përputhje me kriteret e përcaktuara nga standardi. Certifikata GlobalGAP është një pasaportë besueshmërie për një produkt të pastër, pa mbetje toksikologjike", tha Rrapokushi.

Duke iu referuar statistikave, eksperti shpjegoi: "Po të krahasojmë çmimet e shitjes së produkteve në vendet e Ballkanit Perëndimor me çmimet e shitjes në tregjet e vendeve të zhvilluara me vlerë të lartë, vërejmë se ka një çmim më të lartë në këto të fundit".

Sipas tij, duke iu referuar kompanisë Doni Fruits, sjellim shembullin e shitjes së të njëjtit varietet speci, i cili në periudhën 24 - 28 shtator 2021 në dy vende ballkanike u shit me 0.65€ dhe 0.70 € ndërsa në Suedi u shit me 0.95€ dhe në Gjermani me 0.97€ dhe 1€/kg.

Shqipëria ka avantazhin e hershmërisë së pjekjes dhe vjeljes së perimeve në krahasim me 5 vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, e cila duhet shfrytëzuar me efikasitet më të madh nëpërmjet arritjes dhe zbatimit të standarteve të larta siç është edhe certifikimi GlobalGAP.

Aktualisht në sektorin e eksportit të frutave dhe perimeve vërehet që interesi i kompanive të mëdha serioze nga vende të zhvilluara si Gjermania, Anglia, Austria, Suedia etj., sa vjen e rritet.

"Për produktet shqiptare ka interes të madh, për shijen dhe cilësinë e tyre. Por kjo nuk do të thotë se kemi arritur gjithçka, përkundrazi, ka shumë për të bërë për të qenë në krye të

vendeve të Ballkanit Perëndimor në eksportet e perimeve. Duhet të punojmë që të plotësojmë në vazhdimësi standartet në çdo hallkë të zinxhirit të furnizimit, që nga ferma deri sa produkti arrin në destinacion,

nies së punëtorëve, apo edhe të certifikimeve të tjera kërkojnë edhe infrastrukturë të përshtatshme, plotësimin e kushteve për higjienën dhe sigurinë e produktit dhe të punëtorëve si në fermë edhe në njësitë e





dhe në këtë zinxhir të gjatë përfshihen shumë faza dhe procese, që nga përgatitja për mbjelljet, te trajtimet me PMB në fazat e paravjeljes, procesi i vjeljes, i transportit, i seleksionimit, paketimit, etiketimit, procesi i gjurmueshmërisë së produktit dhe transporti te klienti final", tha ai.

Rrapokushi solli në vëmendje të prodhuesve se "nuk duhet të harrojmë gjithashtu që certifikimi me GlobalGAP, Standardet Globale të Konsorciumit Britanik të Shitjes me Pakicë (BRC) që specifikojnë kriteret e sigurisë, cilësisë dhe funksionimit për prodhuesit dhe furnizuesit e ushqimit, (BRC) apo moduli GRASP që ë[LL1] shtë një modul vullnetar, për të vlerësuar praktikatat sociale në fermë, në aspektin specifik të shëndetit, sigurisë dhe mirëqë-

grumbullimit dhe të paketimit, ruajtjen e mjedisit, si edhe trajnimin e punonjësve".

Trajnimet vijoi ai, janë një element i rëndësishëm i procesit të certifikimit, dhe për më tepër promovimi dhe ndarja e eksperiencave pozitive me fermerët në kultivimin e perimeve sipas standarteve të larta duhet patur në vëmendje, sepse nxisin progresin dhe kooperimin ndërmjet tyre.

Andon Rrapokushi, Menaxher i Departamentit të Certifikimeve Doni Fruits tha për "Agrobiznesin" se "vlen të theksohet se për të nxitur zbatimin dhe masivizimin e standardit GlobalGAP rol mund të duhet të luajë edhe Ministria e Bujqësisë nëpërmjet politikave të saj mbështetëse dhe subvencioneve për këtë lloj certifikimi në grup".



KASH adreson kërkesat për zgjidhjen e problemeve që ndesh blegtoria sot

KASH, në përgjigje të shqetësimit në rritje të shoqatave anëtare, që punojnë në Sektorin e Blegtorisë dhe jo vetëm, për situatën e vështirë në të cilën ndodhet ky sektor, disa nga treguesit kryesorë të të cilit vijnë të përkeqësohen, organizoi Tryezën tematike për sektorin e Blegtorisë, ku mori edhe mbështetjen e Ministrave të Bujqësisë në vite, si dhe mirëkuptimin dhe kujdesin e vecante të Rektorit të Universiteti Bujqësor të Tiranës, Prof. Fatbardh Sallaku dhe Ministres së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Znj. Frida Krifca.

Në këtë tryezë tematike ku morën pjesë aktorëve të rëndësishëm të sektorit, u parashtruan piketat e një forumi të gjerë me ide, iniciativa dhe masa që duhen marrë, në mbështetje të blegtorisë.

Ndër piketat kryesore ishin: Sektori i prodhimit dhe përpunimit të ushqimeve për blegtorinë duhet mbështetur me përparësi përmes një projekti

pilot asistence teknike dhe financiare, për të futur në rrugën e zgjidhjes kapacitetet e pamjaftueshme të prodhimit dhe përpunimit të ushqimeve për blegtorinë, nivelin e ulët të mekanizimit, koston dhe çmimet e larta të tyre, si dhe konkurrencën e pandershme që ju bëhet prodhuesve vendas nga importuesit e ushqimeve për blegtorinë.

Censusi për Blegtorinë është një tjetër mjet efikas, që duhet përdorur më shpesh për të vlerësuar realisht situatën. Përdorimi masiv i këtyre instrumentave dhe platformave, si dhe përfshirja e FED INVEST, KASH, UBT dhe institucioneve të tjera të arsimit të lartë, për të mundësuar zbatimin me efikasitet dhe me sa më pak shpenzime të këtyre sistemeve elektronike, është një mundësi reale, e cila krijon kushte për marrjen e vendimeve të duhura, që mund të realizohen pa humbur shumë kohë në kushtet aktuale.

Shtimi i numrit të Projekteve pilot. Ato janë një mundësi e

mirë për ndërtimin e modeleve bashkëkohore, që t'i shërbejnë jo vetëm sektorit të blegtorisë, por edhe Turizmit rural dhe përmirësimit të mjedisit në zonat rurale, për të realizuar në një periudhë sa më të shkurtër objektivat e miratuara. Projekte të tilla pilot mund të realizohen si fillim në bashkëpunim me Shoqëritë e Bashkëpunimit të regjistruara në QKB, përmes nënshkrimit të kontratave kolektive, duke i mbështetur këto subjekte financiarisht me grante, për përdorimin e teknologjive bashkëkohore të përpunimit të mbetjeve blegtoriale, si dhe mbetjeve të tjera organike, që dekompozohen në natyrë dhe ndotin mjedisin; për prodhimin e plehut organik të pastër, për mbështetje me mjete të specializuara për transportin e kafshëve të gjalla; mbështetje fillimisht për ndërtimin dhe funksionimin e disa tregjeve model, për grumbullimin dhe shitjen e kafshëve të gjalla, si në tregun vendas dhe në eksport etj.

Presidenti Biden takim me fermerët dhe blegtorët për të nxitur konkurrencën

Presidenti Joe Biden tha se administrata e tij do të miratojë rregulla të reja dhe një fond prej 1 miliard dollarësh për të mbështetur industrinë e mishit dhe fermerët. Këto masa do të ndërmerren në kuadrin e përpjekjeve për të zgjidhur problemin e mungesës së konkurrencës në këtë sektor të ekonomisë amerikane.

kohë që bie oferta që iu bëhet fermerëve për produktet e tyre. Kjo është pasqyrë e një tregu të prishur nga mungesa e konkurrencës. E kam thënë më parë dhe po e them sërish: kapitalizmi pa konkurrencë nuk është kapitalizëm. Është shfrytëzim. Këtë po shohim tani në industrinë e mishit dhe pularisë. Fermerët e vegjël dhe

amerikane. Një analizë e fundit e Shtëpisë së Bardhë konstatoi se katër kompanitë kryesore të prodhimit të mishit - Cargill, Tyson Foods Inc., JBS SA dhe National Beef Packing Co. - kontrollojnë nga 55% deri në 85% të tregut të mishit të derit, viçit dhe të pulës. Gjithashtu, Departamenti i



Presidenti Joe Biden, Sekretari për Bujqësinë Tom Vilsack dhe Prokurori i Përgjithshëm Merrick Garland gjatë konferencës me fermerë dhe blegtorë (3 janar 2022)

Presidenti Biden zhvilloi një takim virtual me fermerët dhe blegtorët të hënën për të parashtruar iniciativat për të ulur çmimet e ushqimeve, nëpërmjet rritjes së konkurrencës brenda industrisë së mishit.

"Kompanitë e mëdha po arrijnë fitime masive. Ndërsa iu rritet fitimi, edhe çmimet që shikoni në dyqane rriten në mënyrë proporcionale; ndër-

blegtorët e pavarur po falimentojnë; ndonjëherë janë biznese që kanë funksionuar me breza të tërë", tha ai.

Presidenti Biden shtoi se administrata e tij do të sigurohet që prodhuesit e vegjël të mishit kanë mjetet që ju duhen dhe një treg të drejtë. Ai gjithashtu tha se administrata e tij do të luftojë për çmime të drejta për fermerët, blegtorët dhe familjet

Bujqësisë do të propozojë këtë vit rregulla për të forcuar zbatimin e legjisllacionit përkatës dhe qartësimin e aplikimit të emërtimit "Produkt i Shteteve të Bashkuara". Fermerët vendas thonë se kompanitë shumëkombëshe kanë fituar avantazh të padrejtë nëpërmjet rritjes së bagëtisë jashtë vendit dhe sjelljes vetëm në fund në thertoret në Shtetet e Bashkuara.

LETËR E HAPUR

PROBLEMET DHE ÇËSHTJET QË SHQETËSOJNË BKFSH-NË

BASHKIMI KOMBËTAR I FERMERËVE LETËR TË HAPUR KRYEMINISTRIT EDI RAMA PËR HEQJEN E RIMBURSIMIT TË TVSH-SË PËR PRODHIMET BUJQËSORE, MBËSHTETJEN ME GRANTE PËR MEKANIKË, PËRMIRËSIMIN E SKEMËS SË SUBVENCIONEVE DHE RRITJEN E INVESTIMEVE NË UJITJE E KULLIM

Letër

Dt.06.01.2022

Z. Edi Rama
Kryeministër i Shqipërisë

I nderuar Z. Kryeministër!

Bashkimi Kombëtar i Fermerëve Shqiptarë (BKFSH), ju uron gëzuar vitin e ri 2022, shëndet, mbarësi dhe suksese në mandatin e tretë qeverisës!

BKFSH është një organizatë jo-fitimprurëse e bujqëve të pavarur dhe fermerëve, e krijuar në vitin 1994, me ndihmën dhe asistencën e USAID. Ajo është anëtare themeluese e Këshillit të Agrobiznesit Shqiptar (KASH). Objekti i saj kryesor është partneritet me MBZHR dhe qeverinë, për zhvillimin e sektorit të bujqësisë, në harmoni me gjithë sektorët e tjerë të Ekonomisë së Ushqimit. Gjithashtu është edhe në opionencë me institucionet e sektorit publik dhe në mbrojtje të interesave të antarëve të vet.

BKFSH vlerëson arritjet pozitive jo vetëm në zhvillimin e sektorit të bujqësisë, veçanërisht në vitet 2014, 2019, por edhe në të gjithë sektorët e tjerë të Ekonomisë së Ushqimit në Shqipëri, si atë të: Blegtorisë, Peshkimit dhe Akuakulturës, Agrobiznesit, Agropërpunimit, Bimëve Mjekësore Aromatike dhe Bletarisë, Agroturizmit, Agropylltarisë dhe Mjedisit në zonat rurale, Tregjeve Agro-Blegtorale, Financës, Mikrofinancës dhe përmirësimit të legjislacionit që impakton zonat rurale.

Tërmeti i 26 nëntorit 2019, kushtet e pafavorshme atmosferike, si përmbytjet, ngricat, zjarret, dëmet nga sëmundjet në kafshë dhe bimë, pandemia Covid 19, konjuktura e pafavorshme në rritje të vazhdueshme e çmimeve të importit, ndryshimet e shpeshta dhe të pakonsultuara me BKFSH të Paketës Fiskale, financim i pamjaftueshëm nga buxheti shtetit, për mbështetjen e sektorëve të Ekonomisë së Ushqimit, gjithashtu po të shtojmë edhe plagët e vjetra të trashëguara si pasojë e Ligjit 7501 "Për tokën", informalitetin e lartë, mungesën e mekanizimit, konkurrencën e pandershme që na bëhet nga importi, për prodhimet e subvencionuara më shumë në vendet nga importojmë për prodhime të njëjta, vështirësitë për të siguruar prodhimet në shoqëritë e sigurimit etj., të shqetsuar për të tashmen dhe të ardhmen na detyruan t'u drejtohemi edhe Ju Z. Kryeministër, për të vlerësuar realisht situatën në të cilën ndodhen antarët e BKFSH.

Problemi ynë madhor ka qenë dhe mbetet procesi i veshitirë i Kooperimit dhe Koordinimit. Bujqit e pavarur individualë, që kanë nën 1 ha tokë, janë aktualisht mbi 80 % e fermerëve që kanë përfituar tokë bujqësore falas sipas ligjit 7501. "Per tokën". Përfituesit e tokës, veçanërisht rinia po largohen nga vendbanimet e tyre në zonat rurale, për një jetë më të mirë brenda dhe jashtë vendit. Ata janë në të

drejtën e Tyre të përipiqen për një jetë më të mirë, por sipërfaqja e tokës bujqësore që Ata kanë përfituar falas nga ligji 7501, po mbetet djerrë pa u punuar dhe pa u kultivuar. Shqipëria është vendi me më pak tokë bujqësore/banorë në Europë dhe më gjerë. Fermerët nuk po kooperohen sepse politika fiskale e zbatuar deri tani nuk po e favorizon kooperimin. Mbështetja për procesin e kooperimit nga qeveria ka qenë e pamjaftueshme. Instrumenti kryesor që ndihmonte formalizimin dhe kooperimin, që ishte rimbursimi i TVSH për prodhimet e fermerëve nga 20 % u be zero %. Tregu i shitblerjes së tokës si pasojë e paketës fiskale jo nxitëse dhe mungesës së certifikatave të pronësisë së tokës bujqësore nuk po funksionon sipas ligjeve të ekonomisë së tregut. Ligji 38/2012 Për Shoqëritë e Bashkëpunimit Bujqësor SHBB, ka mbetur ashtu si është formuluar 10 vite më parë, jo i plotë dhe pa asnjë akt nënligjor. Qendra Kombëtare Biznesit QKB për fermerët aktualisht vepron mbi bazen e këtij ligji, por pa asnjë efekt dobiprurës për veprimtarinë tyre. Problemi e kemi ngritur, propozime kemi bërë për zgjidhje, por deri tani asnjë rezultat dobiprurës. Kemi dëgjuar deklaratat Tuaja në mbështetje të procesit të kooperimit dhe koordinimit, por ju lutemi të ndërhyni për këtë proces ashtu si Ju vepruat me mbështetjen që u dhatë për qendrat e grumbullimit të prodhimeve bujqësore. Sipërfaqja e tokës djerrë e bujqëve të pavarur po rritet nga viti në vit në zonat rurale.

Mekanizimi, inovacioni dhe dixhitalizimi në të gjithë sektorët e Ekonomisë së Ushqimit janë ndër instrumentat më dobiprurës për të rigjallëruar të gjithë sektorët e Ekonomisë së Ushqimit. BKFSH vlerëson shumë politikën dobiprurëse që po ndjek qeveria duke ndërhyrë për të reduktuar çmimin e karburantit që përdoret në sektorin e bujqësisë dhe peshkimit. Premtimi Juaj për ta rritur vit mbas viti buxhetin e vënë në dispozicion për këtë qëllim jemi besimplotë që do të bëhet realitet. Masa që po zbatohet ndihmon jo vetëm fermerët por akoma më shumë ndihmon mekanizatorët që punojnë në tokat e tyre dhe për të tretë. Projekti IPARD II dhe Projekti SARED dhanë ndihmesë për rinovimin e parkut të mjeteve të mekanikës bujqësore. Por vëmendja duhet të mos largohet nga procesi rinovimit të këtij parku, i cili është i vjetër, me kosto të lartë mirëmbajtjeje dhe i prodhuar me një teknologji që i ka kaluar koha.

Financimi, disbursimi fondeve grant, kompesimi dëmeve të fermerëve si rezultat i faktorëve objektiv dhe subvencionimi janë probleme madhore dhe shumë shqetësuese për BKFSH. Mbështetja me financim nga buxheti në raportin 2-2,2 % të shpenzimeve totale për MBZHR është i pamjaftueshëm edhe për të realizuar objektivat më minimale që Ju Z. Kryeministër keni premtuar për mandatin e tretë. Reduktimi me 55 % i buxhetit për mbështetje të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit për vitin 2022 është një shqetsim shumë i madh për BKFSH dhe

ju informojmë se që këtë vit bujqësor do të ketë pasoja të drejtpërdrejta në sasi, rendiment dhe koston e prodhimit të fermerëve. Fakti që në vitin 2022 nuk do të kemi edhe mbështetjen e Projektit të Bankës Botërore për Infrastruktura të Ujitjes dhe Kullimit do e rëndojë më shumë situatën. Zgjerimi kapaciteteve dhe mirëmbajtja e infrastrukturës së kullimit dhe ujitjes është potenciali dhe rezerva më dobiprurëse që kemi në dispozicion si vend. Mungesa e vëmendjes dhe neglizhenca edhe për një kohë të shkurtër e këtij sektori është me pasoja të mëdha financiare dhe ekonomike për të ardhmen tonë. Skema e subvencionimit duhet të përmirësohet, ka ardhur koha të kalohet në skemën e subvencionimit për njësi prodhimi të dorëzuar me faturë tatimore në subjektet e përcaktuara. Në situatën që po kalojmë aktualisht fermerët blegtorë janë në veshitirësi më serioze dhe në vijim po reduktojnë ndjeshëm aktivitetin e tyre. Ne kërkojmë vëmendjen Tuaj të veçantë për frenimin e rënies së treguesve në këte sektor.

Përmirësimi legjislativ që impakton të gjithë sektorët e Ekonomisë së Ushqimit është tashmë një domosdoshmëri, për të garantuar një rritje të qëndrueshme të prodhimit. Disa ligje duhen amenduar pa humbur kohë dhe me konkretisht:

Ligji nr. 10465 dt. 29.09.2011 "Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë"

Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë; Miratuar me ligjin me nr. 8378 date 22.07. 1998, ndryshuar me ligjin nr. 9808 date 24.09. 2007 dhe ligjin nr. 10488 date 05.12.2011.

Ligji nr. 62/2012 "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë"; Ligji nr. 38/2012 "Për Shoqëritë e Bashkëpunimit Bujqësor";

Ligji nr. 9817 datë 22.10.2007 "Për Zhvillimin Bujqësor Rural".Ligji 10431 /2011 " Për mbrojtjen e mjedisit"

Ligji 10463/2011 "Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve":

Hartimi dhe miratimi i një ligj të ri "Për Siguracën në hallkat kryesore të subjekteve prodhuese të zinxhirit për furnizimin e popullit me ushqime". Etj.

Z. Kryeministër problemet dhe hallet tona janë të shumta, të veshitira për t'u zgjidhur, por Ne krahas Ministres së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Znj. Frida Krifca , e cila na priti dhe dëgjoji me vëmendje, po ju drejtohemi edhe Ju me këtë letër me besimin se një takim me Ju për t'ju sqaruar më mirë dhe angazhimi Juaj do të na e lehtësojë akoma më shumë punën për zgjidhjen e halleve dhe problemeve tona.

Me respekt
Hazis Sava
Kryetar i BKFSH

Akademia e Shkencave të Shqipërisë dhe Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës rezolutë në simpoziumin shkencor "Vreshtaria dhe verëtaria në hapësirën mbarëshqiptare"

KASH (Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar) kontribut në hartimin e rezotutës për vreshtarinë

Në Shqipëri dhe në Kosovë, vreshtaria dhe verëtaria përbëjnë vlerë të shtuar për ekonominë kombëtare. Përparimi ekonomik dhe i turizmit, kanë mundësuar zhvillime të mëtejshme në këtë sektor, por ende nuk janë përdorur sa duhet pozicioni gjeografik i privilegjuar dhe investimet e kryera për vreshtarinë dhe verëtarinë. Problem madhor është konsolidimi i prodhimit cilësor në rrush e verëra dhe standardizimi i mirëfilltë i tij, përcaktimi e zbatimi i strategjisë dhe poli-

tikës për zhvillimin e vreshtarisë-verëtarisë në nivel më të plotë të interesave kombëtare, duke shtuar prodhimin vendës që duhet të mbizotërojë në tregun shqiptar.

Të mbledhur në këtë Simpozium Shkencor që u organizua me mbështetjen e dy Akademive të Shkencave në Shqipëri dhe në Kosovë, me qëllim nxitjen e prodhimit cilësor vreshtar e verëtar, mundësimin e integritetit të dy vendeve tona edhe në zhvillimet rajonale e botërore

të vreshtarisëe të verëtarisë, si edhe për të mbështetur ecurinë dhe prirjen shumë në rritje të kërkesës së tregut për këto prodhime, paraqesim këto përfundime dhe rekomandime, në përputhje me 35 kumtesat dhe diskutimet që u parashtruan në simpozium:

• Hartimi i një programi shkencor mbarëkombëtar lidhur me orientimin strategjik të politikave për ruajtjen e burimeve gjenetike të hardhisë, për kultivarët-ekotipet-popullatat

autoktone. Veçanërisht ato në rrezik zhdukjeje në Shqipëri e në Kosovë. Ky Program të përfshijë përmirësimin gjenetik të kultivarëve dhe prodhimin e kloneve të fidanëve, fillimisht për Sheshin e Bardhë, Sheshin e Zi, Kallmetin dhe Vrançin, që përbëjnë prodhimin më të madh të rrushit dhe të verërave shqiptare. Kjo veprimtari do të mundësojë identitetin-cilësinë-standardizimin e prodhimit vendës, krijimin dhe stabilizimin e stileve të verërave tona. Përparësi i duhet dhënë pro-

dhimit të verërave që përftohen nga përpunimi i rrushit të kultivarëve autoktonë, duke u mbështetur me rregulla administrative e kontrolli dhe me investime shtetërore, duke u bërë më të njohura edhe nga ana e mediave.

• Përmirësimi i legjislativitetit për vreshtarinë dhe verëtarinë, si pjesë edhe e procesit të përafrimit me rregulloret përkatëse të BE. Përfshirja e komunitetit shkencor dhe e agrobiznesit, përfshirë sidomos verëtarët, në

diskutimin mbi projektligjin e përgatitur në Shqipëri, "Për vreshtarinë dhe verëtarinë", ku detajohen gjithashtu kriteret për: Përcaktimin e Emërimitin e Prejardhjes së Mbrojtur dhe Kontrolluar të verërave, llojet e verërave për përdorim dhe karakteristikat përkatëse, politikë mbrojtëse për prodhimin vendës dhe mbështetjen me subvencionime shtetërore për fermat vreshtare dhe verëtarët. Mënjanimi i trysnisë fiskale të

CERTIFIKIMI GLOBAL GAP

Eksporte në tregje me vlerë të lartë Fermerët përfitojnë nga certifikimi në grup me GlobalGAP

Në Shqipëri ka filluar dhe po zbatohet opsioni 2 i certifikimit në grup me GlobalGAP, i cili është opsioni më i mirë për fermerët shqiptarë për arsye të lehtësirave që ai ofron në krahasim me certifikimin individual.

Andon Rrapokushi, Menaxher i Departamentit të Certifikimeve Doni Fruits, në këndvështrimin e ekspertit vlerëson se, trendi në rritje të eksportit të perimeve tregon që zbatimi i standardeve të larta të prodhimit dhe përpunimit të produkteve nuk duhet të konsiderohet më si një dëshirë apo një detyrë fakultative për prodhuesit dhe eksportuesit shqiptarë. Por një detyrë primare zbatimi i së cilës ka lidhje të drejtpërdrejt me sigurinë ushqimore, me një jetesë të shëndetshme, me kërkesën e konsumatorëve dhe të klientëve potencialë, me ruajtjen dhe forcimin e pozitave në tregjet e eksportit.

Në një intervistë për gazetën "Agrobiznesi" Rrapokushi tha: "Tema e produkteve të shëndetshme që konsumojmë është një nga temat më të rëndësishme të dekadës së fundit jo vetëm në nivel evropian por edhe global. Në vitin 2015 OKB përcaktoi 17 objektiva për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik-social (SDG – Sustainable Development Goals) për tu arritur deri në vitin 2030, dhe rreth 5 ose 6 prej tyre janë të lidhura pikërisht me ushqimin, sidomos dy prej tyre: Objektivi 3 "Shëndet të mirë dhe mirëqenie - Good health and well being" dhe Objektivi 12 "Prodhim dhe konsumim të përgjegjshëm - Responsible Consumption and Production", të cilat janë të lidhura ngushtësisht me sigurinë ushqimore.

Nga kjo parantezë kuptohet që nuk mund të kesh produkte të shëndetshme pa standarde të larta prodhimi dhe përpunimi. Ndaj, që të arrihen këto standarde duhet të kalohet nëpër një proces të mirëfilltë certifikimi, një prej të cilëve, ndër më të rëndësishmit është certifikimi GlobalGAP. Ka rreth 3-4 vite që në Shqipëri ka fil-

uar dhe po zbatohet opsioni 2 i certifikimit në grup GlobalGAP, i cili është opsioni më i mirë për fermerët shqiptarë për arsye të lehtësirave që ai ofron në krahasim me certifikimin individual dhe konsiderohet standardi i praktikave të mira bujqësore globale. Zbatimi me sukses i këtij certifikimi nga disa kompani eksportuese dhe SHBB në vendin tonë, të cilat kanë organizuar grupe prodhuesish, është një nga faktorët kryesorë që ka ndikuar në rritjen e eksporteve të perimeve në Shqipëri, posaçërisht në tregjet me vlerë të lartë. Të kesh produkte të certifikuar me standartin GlobalGAP do të thotë të kesh avantazh mbi prodhuesit dhe kompanitë e tjera që nuk e kanë këtë certifikim global. Dodo të thotë jesh i besueshëm tek klientët potencialë të cilët paguajnë më shumë në këmbim të plotësisht



të standardeve, të forcosh pozitativat në tregjet me vlerë të lartë.

Ka shembuj konkretë që e vërtetojnë këtë; në zonën e Lushnjes, Beratit, Sarandës etj të cilat janë edhe zonat më potenciale të eksportit të perimeve dhe të mandarinës, janë disa kompani dhe SHBB që zbatojnë certifikimin GlobalGAP në grup. Mund të përmendim kompaninë Doni Fruits në Lushnje e cila zbaton me sukses këtë certifikim për tre vite radhazi, dhe aktualisht janë 9 produkte të certifikuar, ku ndër kryesorët dhe më të kërkuarit në tregjet me vlerë

të lartë janë domatja, speci, mandarina, shalqiri dhe sallata Iceberg. Eksportet në 5 vitet e periudhës 2016-2020 të kësaj kompanie kanë ardhur gjithmonë në rritje, si në volum me një rritje vjetore prej 1.500 tonësh, edhe në të ardhura me rritje rreth 9-10%. Marrja e çertifikatës GlobalGAP nga viti në vit është një nga faktorët kryesorë të këtyre arritjeve.

Eksperti Rrapokushi, thekson: "Certifikimi i produkteve në përgjithësi dhe ai GlobalGAP në veçanti është një detyrë e cila duhet të përqafohet dhe të zbatohet nga një masë shumë më e madhe fermerësh, sepse për hir të së vërtetës numri i fermerëve të certifikuar tek ne është ende i vogël në krahasim me numrin total të fermave që kemi. Sa më shumë fermerë të certifikuar, aq më shumë produkte cilësore do të kemi, si për tregun vendas,

edhe për eksport.

Certifikimi, duke qenë një detyrë komplekse, përfshin në vetvete jo vetëm aspektin praktik por edhe atë teorik, dokumentacionin. Kërkesat dhe kriteret e standardeve nuk mund t'i vërtetosh me fjalë, verbalisht, ato duhen vërtetuar si me fakte dhe veprime konkrete, të prekshme, ashtu edhe me një dokumentacion të plotë të procedurave, i cili është dy llojesh, elektronik dhe fizik. Edhe në këtë drejtim ka shumë për të bërë, pasi kultura e pergatitjes dhe ruajtjes së dokumentacionit ka mangësi".

Certifikimi me GlobalG.A.P, mundësi për rritjen e vlerës të produkteve të eksportuara

Drejtorja e Përgjithshme e Akreditimit në Shqipëri, kompetenca dhe kapacitet për të dhënë akreditimin në përputhje me ISO 17065

Ekspertja MSc. Enilda Lama, nga Kontrolli Evropian i Cilësisë dhe Sigurisë (EQSC), organi certifikues i sistemeve të menaxhimit, në një prononcim për gazetën "Agrobiznesi" shpjegoi rolin dhe rëndësinë që kanë trupat certifikuese në Shqipëri për verifikimin, implementimin dhe përmbushjen e

Inspektorë, Auditues/ Verifikon implementimin dhe përmbushjen e kërkesave të GlobalG.A.P -it.

Lama bën të ditur: "Drejtorja e Përgjithshme e Akreditimit Shqiptar, nuk është e akredituar në mënyrë që të bëjë akreditimin e trupave certifikuese vendase.

GlobalG.A.P në Shqipëri?

Lama tha se, përfitimet në këtë rast janë të shumta.

Së pari të gjithë operatorët që janë të përfshirë në hallkat që përmendëm më sipër, do të marrin një shërbim vendas, po aq cilësor sa edhe nga një trupë e huaj. Kompetencat e profesionistëve të fushës në Shqipëri janë konsoliduar ndër vite, me bashkëpunime e trajnime me të huajt dhe konkurrojnë në mënyrë dinjitoze për sa i përket njohurive teknike por edhe atyre të organizimit dhe funksionimit të hallkave të mësipërme, në tregun shqiptar.

Së dyti, shërbimi që do të merret do të jetë në gjuhën shqipe, që do të përmirësojë edhe ndikimin te fermeri për sa i takon detyrave dhe përgjegjësi që ai/ajo ka, përkundrajt zbatimit të kërkesave të standardit.

Së treti, shërbimi i certifikimit GlobalG.A.P nga një trupë shqiptare, ofrohet me një çmim më të ulët dhe konkurrues, sesa një trupë certifikuese e huaj. Kjo për disa arsye: në rastin e një trupe certifikuese vendase tarifat për klient janë më të ulta sesa një trupë e huaj, kosto e udhëtimit dhe akomodimit e dikujt ardhur nga jashtë nuk zbatohet kur auditorët janë lokalë, koha e komunikimit dhe sqarimit të çështjeve apo dhënies së informacionit shtesë është më e shkurtrë.

Së katërti, të ardhurat ekonomike të gjeneruara nga procesi i certifikimit mbeten në vend, duke kontribuar kështu në ekonominë vendase dhe në nivelin e punësimit.

Së fundmi, standardi GlobalG.A.P ka të përfshira edhe skema të tjera pjesë të tij, si GRASP, localG.A.P, etj, të cilat mund të kontrollohen dhe certifikohen me avantazh dhe të mësipërme, direkt nga një trupë certifikuese vendase.



kërkesave të GlobalG.A.P -it.

Lama renditi disa nga përfitimet dhe lehtësitë që do të kenë subjektet prodhuese, në momentin e akreditimit të trupës certifikuese në Shqipëri për certifikimin GlobalG.A.P.

Sipas saj, GlobalG.A.P është një standard i domosdoshëm për eksportet drejt tregjeve me vlerë të lartë.

Lama shpjegon se, në procesin e certifikimit janë tre hallka kryesore që ndërveprojnë:

I. Hallka e Prodhimit:

Fermeri /Grupi i Fermerëve/ Eksportuesi i cili menaxhon grupin e fermerëve

II. Konsulenti/Qendra e Menaxhimit të Cilësisë (QMS)

Asiston/këshillon në implementim, inspekton, auditon dhe menaxhon fermerin apo grupin e fermerëve.

(Konsulenti dhe QMS nuk menaxhojnë, por ata ndihmojnë, këshillojnë, asistojnë në zbatimin e kërkesave të standardit).

III. Trupa Certifikuese e njohur nga GlobalG.A.P

Turpat certifikuese vendase kanë kriter që të akreditohen për ISO/IEC 17065 për vleresimin e konformitetit për produktet bujqësore për GlobalG.A.P dhe pasi të akreditohen ISO 17065 duhet të aplikojnë pranë instancës përkatëse pranë Global G.A.P për njohjen si trupe certifikuese për këtë standard.

Në këto kushte trupat certifikuese vendase do të mund të certifikoheshin (akreditohen) vetëm jashtë vendit pranë institucioneve që janë të akredituara (njohura), duke sjellë më vete edhe kosto më të mëdha shtesë për trupat certifikuese vendase.

Ndërkohë që pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit në Shqipëri ekziston kompetenca dhe kapacitete për ta dhënë akreditimin në përputhje me ISO 17065", thekson Lama.

Por nëse një trupë vendase në Shqipëri do ishte e akredituar, atherë cilat do të ishin disa nga perfitime për certifikimin

Aplikimi për thirrjen e katërt të IPARD II, Rama ndan videon informuese

Në 10 janar u hap thirrja e katërt e programit IPARD II, që do të zgjasë deri më 25 shkurt 2022.

Duke iu drejtuar atyre që duan të investojnë në fushën e turizmit rural, Kryeministri Edi Rama ndau sot një video informuese mbi mënyrën e aplikimit për këtë thirrje.

"Ja si aplikohet për Thirrjen e Katërt të Programit IPARD përmes kësaj video informuese, për të gjithë ata që duan të investojnë në fushën e turizmit rural. Punë të mbarë", tha Rama.

Qytetari i interesuar mund të shkarkojë formularin e aplikimit dhe ta plotësojë atë në

formë elektronike. Për projekte nën 50 mijë euro, aplikanti duhet të shkarkojë dhe plotësojë Projektin Teknik, ndërsa për projekte mbi 50 mijë euro Planin e Biznesit.

Dosja e aplikimit duhet të përmbajë formularin e aplikimit, Projektin Teknik ose Planin e Biznesit, tri oferta për çdo investim,



si dhe dokumentacionin mbështetës.

Aplikimet dorëzohen deri në 25 shkurt, përmes dërgesës postare rekomande, ose dorazi pranë zyrave të AZHBR-së.

Thirrja për të aplikuar është hapur për masën 7 e njohur si "Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i biznesit" me fokus

turizmin rural dhe të natyrës, punimet e artizanatit dhe industrinë e manufakturës si dhe prodhimin e energjisë së rinovueshme.

Buxheti i përgjithshëm në dispozicion të kësaj thirrje është 4.1 milionë euro, nga të cilat 75 % ose 3.075 milionë euro kontribut i BE dhe 25 % ose 1.025 milionë euro kontribut i buxhetit të shtetit.

Shuma minimale e totalit të shpenzimeve të pranueshme që mbështet investimin me grante nga ky program është 10 mijë euro, ndërsa ajo maksimale 400 mijë euro.

Valentina Postoli, përfaqësuesja e KASH-it, anëtare e Bordit të Ushqimit

Me iniciativë të ministres së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca, është rithemeluar Bordi i Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, për një kontribut konkret

ndërveprimit për garantimin e sigurisë ushqimore.

“Referuar një ndër shtyllave kryesore të programit të qeverisë shqiptare ‘Mirëqenie për të gjithë’, siguria

fund të këtij viti, i takon këtij bordi të shqyrtojë e të japë vlerësimin për projektplanin e menaxhimit të krizave të propozuara nga AKU e rrjedhimisht të vlerësojë edhe punën e menaxherit të këtij institucioni.

Drejtoresha e përgjithshme e AKU-së, Jeta Deda, paraqiti planin dhe objektivat e saj për mirëfunksionimin e AKU, me një këndvështrim të ri dhe të detajuar në funksion të sigurisë ushqimore.

Drejtesja e AKU dhe bordi i ri, me mbështetjen e plotë të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, kanë nisur punën për një plan të suksesshëm veprimi me me shumë sfida përpara, përfshirë edhe nevojën për ndërhyrje në ligjin aktual të ushqimit dhe hartimin e legjislacioneve të reja që nevojiten.

ushqimore është padiskutim një ndër kryefjalët e nis-mave e politikave tona”, tha Krifca.

Krifca komunikoi se, në



në detyrat e AKU-së.

Bordi do të përmbajë në strukturën e tij vendimarrëse kryesisht përfaqësues nga shkencë, prof. dr., pedagogë nga Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit, Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit, Fakulteti i Mjekësisë Veterinare, etj.

Krifca, në takimin e mbajtur, vlerësoi faktin se struktura e këtij bordi, i cili po kthehet pas disa vitesh në një organ funksional, me bazë të fortë shkencore dhe teknike, do të ekzistojë jo thjesht si një detyrim ligjor, por për një shërbim aktiv e konkret, për ta çuar në një tjetër standard nivelin e



Krifca: Skema e mbështetjes, fokus prodhimet në serra

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca zhvilloi një takim me fermerët e Lushnjës dhe më pas pa nga afër punën në terren.

MBZHR njoftoi se në takim u diskutua për ecurinë e punëve të tyre të stinës dhe për mbështetjen që duhet të vazhdojnë të marrin nga institucionet përkatëse, lokale e qendrore.

Krifca i ka garantuar fermerëve se do të jetë në çdo kohë pranë tyre e nevojave të tyre, për informim, mbështetje e zbatim të politikave që hartohen për t’ua lehtësuar çdo ditë e më shumë punën e tyre në terren, në serra, në tokë, blegtori e në çdo investim që ndërmarrin.

Skema e mbështetjes kom-

në fokus të së cilës do të jetë mbështetja e prodhimeve në

hën për disa nga shqetësimet në të përditshmen e punës



serrë, sepse aty kemi parë rritje të ndjeshme të produktivitetit, por pa diskutim edhe mbështetja për zhvillimin e blegtorisë

së tyre, siç është dhe rritja e çmimit të plehrave kimike, ministrja theksoi se, synimi është që ky problem, që është mbarëbotëror, të kapërcehet dhe po punohet për këtë, duke u dhënë fermerëve sa më shumë mbështetje në skemën kombëtare.

Në fund të këtij takimi fermerët e vlerësuan të suksesshme skemën e mbështetjes me naftë dhe bënë propozimet e tyre për një ndihmë më efektive, për të cilat u premtua se do të nisi diskutimi dhe planifikimi me ekspertët në MBZHR.

Të pranishëm në këtë takim ishin edhe kryetarja e bashkisë së Lushnjës, Eriselda Sefa, drejtori i përgjithshëm i Politikave dhe Programe vetë Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural, Irfan Terolli, si dhe përfaqësues nga QTTB-të dhe AREB-i.



bëtare do të jetë garancia më e fortë për këtë mbështetje të vazhdueshme.

“Këtë vit, jemi drejt finalizimit të skemës mbështetëse,

dhe për gjithë ciklin e fidanë të fruta-perimeve të certifikuar”, tha ministrja.

Gjatë këtij bashkëbisedimi të hapur ku fermerët u shpre-

Akademia e Shkencave të Shqipërisë dhe Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës rezolutë në simpoziumin shkencor “Vreshtaria dhe verëtaria në hapësirën mbarëshqiptare”

(Vijon nga faqja 3)

tepruar që ushtrohet ndaj verarive. Vera është ushqim për njerëzit, prandaj akcizat për verërat është e nevojshme që të hiqen.

• **Ringritja i një kadastrë në Shqipëri** edhe sipas përvijës së Sistemit kadastror të vreshtarisë në Kosovë, që vepron me regjistër elektronik, duke përcaktuar vendndodhjen gjeografike të vreshtave, ku krahas blloqeve dhe ngastrave prodhuese, të përfshihen edhe: ngastrat “mëmë”, koleksionet kombëtare e rajonale dhe veçanërisht ato të ruajtjes së gjermoplazmës autoktone. Të evidentohen dhe përditësohen ndryshimet vjetore në të gjithë treguesit e përcaktuar ligjorë. Ky kadastrim i mirëfilltë, shoqëruar me politikë fiskale vërtet zbatuese duke regjistruar të gjitha subjektet prodhuese vreshtare e verëtare, do të mënjanojë prodhimin informal dhe konkurrencën e paligjshme, do të shtojë të ardhurat kombëtare.

• **Organizimi i Sistemit për menaxhimin e cilësisë së rrushit, verërave dhe pijeve**

të forta alkoolike, duke përfshirë digjitalizimin e proceseve agrologjike dhe të procedurave përkatëse: shkalla e përdorimit të kimikateve në vresht dhe verari, zbatimin e afateve të vjeljes së rrushit, pranimit të verës deri në certifikimin e saj për tregtim, skemat e vlerësimit organoleptik, deklarimet vjetore të prodhimit të verës dhe të rezervave të saj. Në këtë sistem menaxhimi të përfshihen normativat kyçe për cilësinë: përdorim i plehrave kimike dhe i pesticideve në sasi të kufizuara dhe të kontrolluara, afate vjelje të përcaktuara nga të dy palët kontraktuese (pronar vreshti dhe pronar verarie), prodhimi vetëm 8-10 tonë/ha rrush cilësor për verë, po ashtu cilësore, mospërdorim në verari i kimikateve që janë të dëmshme për shëndetin e njerëzve.

• **Kryerja e një studimi të mirëfilltë të territorit, për përmirësimin e rajonizimit të kultivarëve të hardhisë, drejt specializimit të zonave vreshtare përkultivarin a kultivarët më të përshtatshëm.** Përqendrimi i strukturës varietore në kultivarët më të mirë, më të kërkuar nga tregu, si dhe

në kultivarët autoktonë që janë të përzgjedhur dhe të përmirësuar.

• **Krijimi i vreshtave të reja të konsiderohet i barasvlerëshëm me ndërtime, pra të kenë miratim nga organet e pushtetit vendor, me projekt të plotë ku të përfshihen: toka, klima, rajonizimi, struktura e kultivarëve, skema agroteknike e selitjes së bllokut me vreshta etj., duke bërë rregullimet e nevojshme me akte bashkëkohore ligjore apo nënligjore.**

• **Rishikimi i planit afatgjatë për zhvillimin e vreshtarisë dhe të verëtarisë, për kalimin në prodhimin e verërave EPK – Emërtim me Prejardhje të Mbrojtur e Kontrolluar.**

• Mbështetje institucionale kërkimore shkencore që paraqesin projekte për grumbullimin dhe ruajtjen e gjermoplazmës autoktone dhe të burimeve parësore, për krijimin e koleksioneve gjenetike in vitro veçanërisht në kushte erozioni të theksuar gjenetik. Kjo praktikë përbën themel për markat bashkëkohore të verërave,

me tipicitet të shquar dhe me identitet historik e gjeografik me rëndësi të veçantë, sidomos në kushtet e zhvillimit të agroturizmit dhe turizmit në tërësi.

• **Krijimi i një grupi pune të përbashkët Shqipëri-Kosovë, që të merret me: përditësimet e legjislacionit lidhur me problematikën e vreshtarisë dhe të verëtarisë, me hartimin e Rregullores për prodhimin dhe tregtimin e verërave dhe të pijeve tejet alkoolore, me hartimin e strategjisë lidhur me zhvillimin e vreshtarisë-verëtarisë gjithëkombëtare përgjatë periudhës 2023-2033, me njësimin e Sistemit për kontrollin e cilësisë të rrushit – verës – prodhimeve të tjera nga rrushi e vera, me hartimin e “Atlasit të kultivarëve shqiptarë të hardhisë”.**

• **Harmonizimi i Ligjit të certifikimit të fidanëve në Shqipëri dhe Kosovë, me direktivat e BE-së (Direktiva Implementuese e Komisionit të BE 2020/177), si mundësi e madhe tregu për fidanishtet vendase. Hartimi i një programi shkencor certifikimi për kontrollin fitosanitar e gjenetik të materialit të shumimit,**

duke përdorur metoda bioteknologjike të shëndetësisë dhe të biologjisë molekulare. Prodhimi të kryhet vetëm në fidanishte të certifikuar, për të bërë më efektiv kontrollin shtetëror sipas nevojave të vendit.

• **Përmirësimi i infrastrukturave laboratorike dhe kualifikimi i punonjësve të verarive, në mënyrë që të mundësohet prodhim verërash në nivel bashkëkohor, të drejtuar dhe kontrolluar nga ana e tyre.**

• **Veraritë duhet të vepronë për stabilizimin dhe shumimin e stiveve të verërave shqiptare, si edhe për konsolidimin e markës shqiptare, në përputhje me kërkesat e tregut të brendshëm dhe të eksportit. Të gjitha këto janë parakusht për prodhim më të madh dhe cilësor të këtyre verërave.**

• **Rritja e ndjeshme e pranisë së verërave shqiptare në sektorin e mikpritjes, që tanimë përbën treg shumë të rëndësishëm.**

• **Edukimi i mëtejshëm në sektorin e mikpritjes (restorante, hotele etj), si**

edhe i njerëzve në përgjithësi, lidhur me vlerat dhe përdorimin më të madh të verërave shqiptare.

• **Fuqizimi dhe sidomos modernizimi i marketingut nga ana e verarive, përbën domosdoshmëri për shtimin e prodhimit vendës. Synim madhor duhet të jetë që në tregun shqiptar, brenda tre katër viteve, verërat vendëse nga 30 për qind të arrijnë mbi 50 për qind të sasisë gjithsej, si edhe eksporti të barazohet me importin e verërave.**

• **Propozim qeverive të dy vendeve për ngritjen e Qendrave Kërkimore për Vreshtarinë dhe Verëtarinë në Shqipëri dhe Kosovë, si struktura të posaçme edhe për prodhimin, kontrollin dhe certifikimin e materialit të shumimit të hardhive dhe rregullimin institucionor të bashkëpunimit mes tyre.**

Miratar nga pjesëmarrësit në Simpozium: akademikë, kërkues shkencorë, agronomë, enologë, përfaqësues të bizneseve prodhuese vreshtare dhe verëtare nga Shqipëria dhe Kosova.

Cërrik, impianti i përpunimit të mbetjeve organike redukton ndotjen

Impianti i kompensimit në Cërrik të Elbasanit, një investim i ndërtuar në bashkëpunim me qeverinë shqiptare dhe me mbështetjen e qeverisë gjermane, filloi punën në qershor 2021 dhe ka gjeneruar deri më tani rreth 150 m³ pleh organik të gatshëm për të dalë në treg për herë të parë.

Në këtë impiant përpunohen mbetje organike nga serrat, krasitjet e pemëve, mbetjet e industrisë agropërpunuese dhe ato të grumbulluara nga shërbimi i pastrimit në të gjithë territorin e bashkisë.



Ky investim bën të ditur GIZ Albania, krahas produktivitetit ekonomik dhe social, në bashkinë Cërrik po kontrahon edhe në reduktimin e ndikimit të mbetjeve në mjedis dhe ndryshimet klimatike, duke krijuar mundësi për përfitime ekonomike dhe

sociale. Humusi që përftohet nga procesi i përpunimit të mbetjeve organike: Përmirëson strukturën e tokës ku përdoret; Rrit aftësitë ujëmbajtëse të tokës dhe ul nevojën për plehra kimike duke shërbyer si material natyror ushqyes.

Denoncimi në numrin e gjelbër, AKU zbulon magazinat ku cenohej siguria ushqimore

Një denoncim në numrin e gjelbër të Autoriteti Kombëtar i Ushqimit zbuloi magazinat dytësore ku cenohej siguria ushqimore.

AKU njoftoi sot se, një denoncim në numrin e gjelbër (0800 75 75) të Autoritetit

ambientet frigoriferike dhe ambientin e tregimit.

Gjatë inspektimit u konstatuan produkte të gatshme për hedhje në treg: Produkte me bazë mishi me etiketa të panotifikuara dhe që nuk kishin të

heshin produktet ushqimore nuk plotësoheshin kushtet e nevojshme higjieno-sanitare për këtë veprimtari.

Magazina ishte e pamirëmbajtur dhe brenda saj u konstatua një sasi prej 14'400 kokrra vezësh të paketuara dhe të pavulosura, me mungesë datë skadence dhe pa gjurmueshmëri.

Në ambientet frigoriferike, në kushte të papranueshme u konstatuan 711.5 kg mish, pa dokumentacionin shoqëruar, 100 kg galetë pa etiketë identifikuese.

Grupi inspektues i AKU-së mori masën urgjente të ndërprerjes së aktivitetit të këtij subjekti dhe bllokimin e produkteve sa më lart, me destinacion përfundimtar asgjësimin e tyre, masë administrative gjobë për kushtet higjieno-sanitare dhe masë administrative gjobë për mungesën e gjurmueshmërisë.

Procedura e inspektimit vazhdon duke ndjekur nga afër asgjësimin e produkteve të bllokuara për asgjësim. Me daljen e përgjigjes së analizave nga ISUV do vazhdojnë procedurat e mëtejshme ligjore.

Gjithashtu AKU po përgatit materialin për kallëzim penal të kësaj veprimtarie.



Kombëtar të Ushqimit u bë lidhur me operatorin e biznesit ushqimor me inicial "D." që operon në juglindje të vendit.

AKU urdhëroi planveprimin lidhur me rastin dhe u krye inspektim së bashku me Drejtorinë Rajonale të AKU-së.

Inspektimi fizik u krye në dy adresa, ku subjekti ushtronte aktivitetin, aty ku kryhej procesi i prodhimit të produkteve ushqimore me bazë mish, ambalazhimi i produkteve djathë, peshk, pjesë mish, në

deklaruar në etiketë përbërësit, disa prej të cilëve allergenë kryesorë ushqimorë.

U mor masë administrative gjobë për sa më lart dhe për mosplotësimin periodik të regjistrave të HACCP.

AKU theksoi se, për produktet e bllokuara po dërgohen mostra në ISUV.

Në adresën, me tre ambiente të reja magazinuese që u identifikua referuar të dhënave nga denoncuesi, u konstatuan gjatë kontrollit fizik se aty ku mba-

Domatet kryesojnë me 40% të eksporteve të zarzavateve

Eksportet e domateve vijojnë të kryesojnë me më shumë se 40 % të totalit të eksporteve bujqësore shqiptare.

Sipas statistikave nga MB-ZHR, eksportet e domateve dhe kastravecave u rritën me 10 % në krahasim me vitin 2020, ndërsa eksportet e perimeve arritën vlerën 7.8 miliardë lekë të përfaqësuar nga rritja e kontratave me jashtë për shitjen e domates.

Eksportet shprehen se krahas zgjerimit të investimeve në serra, ku kultivohen më së shumti domatja dhe kastravec, në Shqipëri ka filluar dhe po zbatohet certifikimi në grup me GlobalGAP, si opsiion më i mirë për fermerët shqiptarë për arsye të lehtësirave që ai ofron në krahasim me certifikimin

individual dhe eksporteve të tregje me vlerë të lartë.

Trendi në rritje i eksportit të perimeve tregon që zbatimi i standardeve të larta të prodhimit dhe përpunimit të produkteve nuk duhet të konsiderohet më si një dëshirë apo një detyrë fakultative për prodhuesit dhe

eksportuesit shqiptarë, por një detyrë primare zbatimi i së cilës ka lidhje të drejtpërdrejt me sigurinë ushqimore, me një jetesë të shëndetshme, me kërkesën e konsumatorëve dhe të klientëve potencialë, me ruajtjen dhe forcimin e pozitave në tregjet e eksportit.



Bletari nga Kuçova, shembull mbresëlënës i biznesit familjar fitimprurës

Bletaria është kthyer tashmë në një biznes fitimprurës që po fuqizon ekonominë e fermerëve çdo ditë e më

sektor. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca, solli shembullin e Yllit që rrit

dimëron por puna e një bletari nuk ndalet kurrë. Ylli thotë se, "në muajt e dimrit, përgatitim kosheret për sezonin e ardhshëm".

E shfaq qartë pasionin për zanatin e tij të cilin e ka të trashëguar nga i ati dhe dëshiron ta kalojë edhe te djali.

"Bletarinë e kam të trashëguar nga babai i tij Ismaili dhe këtë profesion unë ia kam mësuar djalit të tij, me dëshirën për të fuqizuar këtë biznes familjar e fitimprurës", tha ai.

Ylli e ka nisur bletarinë me 15 koshere, dhe sot ka 200 koshere. Prodhon kryesisht mjaltë dhe qumësht blete dhe i është përkushtuar tërësisht këtij zanati, pa përmendur kurrë lodhje.



shumë, falë edhe mbështetjes që adreson qeveria për këtë

bletë në Kuçovë. Në këtë periudhë, bleta

Eksportet e prodhimeve bujqësore kapin vlerën 8,830 milionë lekë

Eksportet e prodhimeve bujqësore arritën gjatë vitit të kaluar vlerën e 8,830 milionë lekëve, bëri të ditur INSTAT.

Perimet e freskëta janë produkti më i eksportuar nga grupi i ushqimeve "Made in Albania", me një rritje të shpejtë vitet e fundit si rrjedhojë e investimeve në serra dhe shtimit të sipërfaqes së mbjellë.

Sipas INSTAT, në harkun kohor të 10 viteve të fundit, eksportet e perimeve u shumëfishuan, duke arritur vlerën prej 8,8 miliardë lekë në fund të 2021, nga 464 milionë lekë që shënuan në 2010.

Rritja e të ardhurave nga eksporti ka rritur ndjeshëm

potencialet e bujqësisë në zonat më produktive bujqë-

në rritje ndikuan në rritjen e bizneseve bujqësore,



sore të vendit si Lushnjë, Fier, Berat, ndërsa eksportet

gjithashtu dhe të investimeve në teknologji bashkëkohore.

I kthyer nga emigracioni hap kompani teknologjike në Shqipëri

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca zhvilloi sot një takim me një matematikan të ri, i kthyer

për t'iu përshtatur kërkesave të prodhuesve.

"Takova Arbin sot, një matematikan i ri, kthyer

sisë, shëndetit të tokës dhe të bimëve ku me anë të kamerave multispektrale ndërton modele efektive për mbjelljet, parandalimin e sëmundjeve, humbjet sezonale prej motit dhe monitorimin e proceseve, duke shfrytëzuar me efikasitet burimet ujore dhe nivelet ushqyese të kulturave bujqësore, duke reduktuar kostot dhe rritur produktivitetin", nënvizoi Krifca.

Ministria Krifca shprehet se "Arbi i tha se bujqësinë e sheh si një nga sektorët kyç të përfitimit të shërbimeve të tilla teknologjike dhe punon me agronomët tanë për t'i kuptuar më mirë nevojat e territorit dhe për t'i ardhur ndesh kërkesave të prodhuesve".

"Entuziaste për modelin e të rinjve të Shqipërisë që përqafojnë bujqësinë dhe sjellin vazhdimisht inovacion dhe teknologji në sektor", tha Krifca.



nga studimet në Angli, i cili ka ngritur kompaninë e tij teknologjike në Shqipëri.

Krifca theksoi se Arbi punon me agronomët për t'i kuptuar më mirë nevojat e territorit dhe

nga studimet në Angli që ka ngritur kompaninë e tij teknologjike në Shqipëri fokusuar në përdorimin e dronëve dhe inteligjencës artificiale në shërbim të bujqë-

TË NDRYSHME

Ringrihet sistemi i kullimit të tokave bujqësore në Fier

Një nga investimet e rëndësishme në mbështetje të bujqësisë është edhe garantimi i ujitjes së tokave bujqësore.

kryesorë po bëhet në gjithë fushën e Myzeqesë.

Kryetari i bashkisë Fier, Armando Subashi ndau sot pamje nga ky aksion që vijon

fshatin Sheq Marinas, Subashi tha se “ky është një proces i gjatë, i vështirë dhe shumë i domosdoshëm që merr çdo ditë vëmendjen tonë”.

Ndërhyrjet në sistemin e ujitjes kanë sjellë dyfishimin e sipërfaqes së tokës së punueshme në Shqipëri, duke e çuar atë nga 120 mijë ha në 240 mijë ha.

Ringritja e sistemit të kullimit të tokave bujqësore garanton që fermerët e fushës së Myzeqesë të mos kenë më probleme përmbajtjes të tokave bujqësore prej reshjeve që bien në stinën e dimrit.

Po ashtu, hapja e rrugëve të parcelave është një tjetër element që ecën paralel me sistemin e kullimit dhe vaditjes, në shërbim të fermerëve, prodhimit bujqësor dhe lehtësisë sipërmarrëse.



Në këtë drejtim, ndërhyrje rrënjësore të kanalet kulluese e vaditëse si dhe të kolektorët

çdo ditë në zonat rurale.

Duke iu referuar ndërhyrjes në sistemin e kullimit në

Në rikonstrukcion rruga Përmet-Çarshovë, hov zhvillimit të agroturizmit

Natyrë piktoreske që ofron Përmeti dhe fshatrat përreth tij do të jenë lehtësisht të arrit-

për rikonstrukcionin e rrugës Përmet-Çarshovë po vijojnë me ritme të larta në mënyrë që

dhe kulinarinë përmetare.

Rruga “Përmet-Çarshovë”, pjesë e segmentit rrugor Tepelenë – Përmet – Çarshovë lidh rrugën kryesore kombëtare SH4 me qytetin e Këlcyrës, Përmetit dhe Çarshovës dhe më tej me kufirin me Greqinë në Pikën Doganore të “Tri Urave”. Kjo rrugë është edhe pjesë e segmentit rrugor Tepelenë – Korçë – Kapshticë. Rruga fillon në dalje të qytetit të Përmetit dhe arrin në fshatin Çarshovë.

Ky investim me financim nga qeveria shqiptare dhe zbatim nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit pritet t’i japë një hov zhvillimit të turizmit dhe agroturizmit, si dhe të përmirësojë ndjeshëm kushtet e jetesës për banorët.



shme, falë infrastrukturës që sa vjen e përmirësohet.

Në këtë kuadër punimet

gjatë pranverës turistët vendas dhe të huaj të kenë mundësinë të shijojnë mrekullinë e natyrës


Sa qumësht prodhohet në Shqipëri?! - Shifrat vjetore sipas zonave dhe gjedhëve në të gjithë vendin

Sipas INSTAT numri i gjedhëve ka shënuar një rënie gjatë

%, krahasuar me 2019.

Nga ana tjetër prodhimi

tor, në nivel vendi i qumështit të deles është 65 kg për krerë



duke shënuar rritje me 2,88 %, krahasuar me vitin 2019.

Sipas të dhënave prodhimi qumështit nga dhinë në 2020 është 4,49 % më i ulët se një vit më parë ndërsa rendimenti mesatar vjetor i qumështit nga dhinë në nivel vendi është rreth 126 kg për krerë duke shënuar rënie me 0,28 %, krahasuar me vitin 2019.

vitit 2020 me 12.76 % ndërsa përqendrimi më i madh i tyre ka qenë në qarkun e Fierit dhe në qarkun e Korçës.


Sipas shifrave të publikuara prodhimi i qumështit në vitin 2020 ka qenë 1,05 milionë tonë, duke shënuar një rënie me 5,39 %, në krahasim me vitin 2019 ndërsa struktura e prodhimit të qumështit, referuar vitit 2020 është qumësht lope 85,28 %, qumësht dele 7,10 % dhe qumësht dhie me 7,62 %.

Në informacionin e publikuar nga INSTAT gjatë vitit 2020, prodhimi i qumështit nga lopët ka qenë 897.349 tonë, ose 5,20 % më pak, krahasuar me 2019 ndërsa rendimenti mesatar vjetor i qumështit në nivel vendi në 2020 është 3.028 kg për krerë duke u rritur me 1,56

qumështit nga delet, për vitin 2020, ka pësuar rënie me 8,60 %, krahasuar me vitin 2019 ndërsa rendimenti mesatar vje-

Tab. 2 Prodhimet blegtorale (tonë)

Emërtimi	2016	2017	2018	2019	2020
Qumësht	1.145.097	1.156.286	1.144.353	1.112.196	1.052.192
Mish peshë e gjallë	159.818	161.286	161.373	156.643	150.353
Veze (milionë kokra)	830	811	828	865	861
Mjaltë	3.923	3.614	3.937	4.116	4.599



Lakra dhe brokoli, produkte që mund të rrisin fitimet për bujqit

Ndërkohë që prodhimi i trangullit dhe domates, perimet

% lëndë ekstrakte, yndyrna 2.29 % etj. Lakra është mjaft e

klimë të ftohtë si Ukraina, Polonia, Lituania. Nga të dhënat e siguruar nëpërmjet intervistave të 8 (tetë) kompanive më të mëdha eksportuese, për vitin 2020 dhe deri në muajin Prill 2021 janë eksportuar afërsisht rreth 10,000 ton lakër sallatë, kryesisht e prodhuar në serrat diellore.



Lakra sallatë prodhimtarinë më të lartë kryesisht e ka nga kultivimi në serra, nga ku sigurohen rendimente të larta, rreth 45 ton/ha, si dhe në përputhje të ciklit prodhues me kërkesën e tregut të eksportit.

më të kërkuara në treg dhe më të kultivuara në Shqipëri, hasin në vështirësi për shkak të sezonit të kultivimit, magazinimit dhe ruajtjes, lakra shihet një produkt me i qëndrueshëm.

Një studim nga Programi i Mbështetjes së Agrobiznesit Shqiptar (AASF) një projekt i financuar dhe zhvilluar nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) vlerësoi lakrën si një produkt potencial për rritjen e vlerës së eksportit. Ajo mund të mbillet në çdo kohë, ka rendiment të lartë për ha dhe ruajtja është më e lehtë.

Në tregjet ndërkombëtare kërkesa për lakër po rritet gjithnjë e më shumë për shkak të përfitimeve që kanë në imunitetin e njerëzve. Lakra përmban: Proteina, 1,2 %, celulozë 1 %, lëndë minerale 1 %, 3,29

pasur në vitaminën C në vlerat 60 – 70 miligram, vitaminë A dhe gjithashtu lakra është e pasur me kripëra minerale si Ca, Ka, Na, S etj.

Kultivimi i lakrës si për nga sipërfaqet ashtu edhe për nga rëndësia ekonomike, është një ndër bimët kryesore perimore që eksportohet nga Shqipëria. Kultivohet në periudha të ndryshme kohore, duke filluar nga pranvera e hershme deri në vjeshtën e vonshme. Sipërfaqja e mbjellë me lakër më 2020 paraqitet me një rritje prej 15% në krahasim me vitin 2018. Kjo si pasojë e rritjes së sipërfaqeve me serra diellore dhe përmirësimin e teknologjisë së kultivimit.

Studimi thotë se, tregu i eksportit ka një kërkesë të lartë për lakrën e sezonit dimëror, dhe kryesisht janë vendet me

Çmimet e shitjes për eksport gjatë periudhës Nëntor 2020 – Prill 2021, ka variuar nga 55-70 lek/kg, mesatarisht rreth 60-65lek/kg. Pra, ekonomikisht është siguruar një vlerë financiare e gjeneruar nga eksporti me rreth 6-7 milion euro. Në total, së bashku me tregun vendas parashikohet një vlerë financiare e gjeneruar prej rreth 8-9 milion Euro.

Kultivimi i lakrës për shumë prodhues është i rëndësishëm edhe për faktin se mund të mbillet në periudha të ndryshme dhe mundëson shfrytëzim më racional të tokës duke u mbjellë si para ose post kulturë.

Kostot për një hektarë lakër serë përlllogaritën mbi 1 milionë lekë, ndërsa vlera në eksporte 2,9 milionë lekë.

Revista "Monitor"

ROMË - FAO: Çmimet botërore të ushqimeve në nivele rekord

qimore në botë, mesatarisht arrinte 125,7 pikë, që është nivel më i lartë prej 131,9 pikë në vitin 2011.


Çmimet më të larta të ushqimit kontribuan për rritjen e inflacionit sepse ekonomitë u rimëkëmbën nga kriza e koronavirusit.



FAO paralajmëroi se çmimet më të larta i vënë në rrezik njerëzit më të varfër në vendet e varura nga importet.

Në përditësimin e saj të fundit, agjencia bëri një vlerësim të kujdesshëm nëse presionet e çmimeve mund të reduktohen këtë vit.

”Megjithëse çmimet e larta zakonisht i lënë vendin rritjes së prodhimit, rritjes së çmimeve të mallrave, pandemia aktuale globale dhe kushtet e pasigurta klimatike nuk ngjallin shumë optimizëm për një rikthim në kushte më të qëndrueshme të tregut në vitin 2022”, theksoi në një deklaratë kryeekonomisti i FAO-s, Abdulreza Abasian.



Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar

www.kashalbania.org

Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar



KREDI PËR ÇDO SIPERMARRËS

KREDI E SHPEJTË ME NORMA KONKURRUESE

deri në
7 MILIONË
Lekë



FED
invest 

**GJITHMONË
FINANCË SOCIALE**

BUJQËSIA

Krifca: Nafta pa taksa vijon për peshkimin, së shpejti nis edhe në bujqësi

“Përjashtimi fiskal për karburantin që përdor peshkimi vazhdon teksa skema e naftës pa taksa për bujqësinë fillon shumë shpejt për të dytin vit radhazi”.

Kështu deklaroi ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural,

pritet të nisë së shpejti.

Ministrja informoi se peshkatarët do të vijnë të marrin naftën pa taksa, me çmim burse, krahas lehtësirave të tjera që përfshijnë përjashtimin nga TVSH-ja të rrjetave dhe materialeve të tjera të

shumë qeverive për këtë skemë, por i realizuar për herë të parë në fillim të këtij viti, siguroi mbështetje të drejtpërdrejtë për fermerët që punojnë tokën, duke i lehtësuar ata nga kosto e karburantit në përdorimin e mekanikës bujqësore.

Aktualisht skema e subvencionit të naftës përcakton si përfitues të naftës falas fermerët e kulturave bujqësore, si: bimë arash, misër, fasule, luledielli, sojë, sorgum, grurë, tërshërë, thekër, duhan, panxhar, pam-buk dhe bimë aromatike-mjekësore; drurët frutorë, perime etj. Për kultivimin e 1 ha misër një fermer harxhon 190 litra naftë, ku 56 % e saj do të përfitohet me çmim 63,8 lekë/litrë.

Aplikimi, për të përfituar nga skema e mbështetjes me naftë për bujqësinë bëhet online në portalin e-Albania me vetëdeklarim.

Procesi i kontrollit në terren, pas shpërndarjes së naftës te subjektet përfituese, kryhet nga Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural.



Frida Krifca në komisionin e Kuvendit për Veprimtarinë Prodhuese Tregtinë dhe Mjedisin në interes të pyetjeve të deputetëve të opozitës për këtë çështje.

Krifca tha se, qeveria mbështet me fonde subvencionin e naftës në sektorin bujqësor për vitin 2022 dhe kjo skemë

peshkimit.

Për vitin 2022 fondi në dispozicion të skemës naftë pa taksa në bujqësi, parashikohet të arrijë në 792 milionë lekë.

Subvencioni i naftës në bujqësi është një nga politikat më të mirëpritura nga komuniteti rural. Premtim i kahershëm i

Elbasani, potencial në turizmin e natyrës dhe atë rural

Agjencia e Zhvillimit Bujqësor Rural (AZHBR) vijoi takimet informuese për thirrjen e katërt, masa 7, të IPARD II, në qarqet e Dibërës dhe Beratit, ndërsa ndalesa e radhës ka qenë në Elbasan.

“Së bashku me Autoritetin Menaxhues të programit IP-ARD informuam të interesuarit për kriteret e thirrjes së katërt, masa 7, për sektorët e turizmit rural si edhe punimet e artizanatit”, u shpreh drejtoresha e Përgjithshme e AZHBR-së, Eranda Selmanaj.

Selmanaj tha se, Elbasani është një qark me interes të lartë në fushën e turizmit të natyrës dhe atë rural, shumë afër kryeqytetit.

Sipas saj, territori i gjerë

dhe alternativat kodrinore, malore dhe liqenore, e bëjnë Elbasanin një destinacion tepër të frekuentuar dhe me rezultate të mira në fushën e bujqësisë, blegtorisë, përpunimit dhe tur-

izmit.

Takimet do të vazhdojnë dhe në qarqet e tjera sipas axhendës të publikuar në faqen e AZHBR.

Thirrja do të mbyllet më datë 25 shkurt 2022.



Vlerat e një limoni në ditë për organizmin

Limonët, këto agrume të athëta janë shumë të mira sa sjellin ëmbëlsinë e duhur në shëndetin e organizmit tonë dhe jo vetëm.

Për fat të keq limonët nuk mund t'i hamë veçmas aq lehtë sa frutat e tjera, por për fat të mirë ato shkojnë me çdo ushqim.

Vitaminat dhe mineralet janë pasuria më e madhe që na ofrojnë limonët duke u transformuar në një prej frutave më të shëndetshme.

Mënyrat e shijimit të limonit janë të shumta dhe të shëndetshme.

Limonin mund ta shtrydhni në ujë dhe ta pini në mëngjes, mund ta përdorni në sallata ose supa ndërkohë që lëkurën e tij mund ta përdorni në ëmbëlsira.

I gjithë fruti ofron mirësi gjithëpërfshirëse ndaj kemi listuar përfitimet e menjëhershme që merr organizmi me konsumin e një limoni të vetëm çdo ditë.

Dukeni më të rinj

Nëse konsumoni më shumë limon lëkura juaj do të marrë shkëlqimin e shëndetit.

Limoni është i pasur me vitaminë C që mban larg rrudhat dhe hidraton lëkurën.

Tensioni i gjakut ulet

Ngrënia e rregullt e limonit çdo ditë ul tensionin e gjakut. Por kjo nuk do të thotë se limoni është i vetmi që ju duhen për të mbajtur tensionin në nivele të përshtatshme.

Sidoqoftë e vërteta është se me një limon në ditë rregulloni nivelet e tensionit.

Larg inflamacionit

Vitamina C tek limoni është e nevojshme kundër të ftohurës, lodhjes, problemeve me tretjen, luhatjeve të humorit.

Vitamina C lufton edhe inflamacionin që është vatra e shumë sëmundjeve kronike.

Kjo vitaminë është e domosdoshme për mbrojtjen e qelizave imunitare.

Shërohemi më shpejt

Vitamina C tek limoni është kryesore në shërimin e shpejtë nga e ftohura.

Kjo vitaminë ka ndikim pozitiv edhe kundër problemeve respiratore që shoqërojnë virozat e stinës, ndaj pini më shumë ujë me limon.

Do të jeni më të hidratuar

Uji është i nevojshëm por pak i mërzitshëm. Kombinoni me limon për t'i dhënë shije, por edhe për të marrë vitaminë e minerale të cilat përshejtojnë metabolizmin dhe ju japin më shumë energji.

Era e mirë e gojës

Limoni freskon shtëpinë. E

Krifca: Ndryshimet ligjore fuqizojnë kontrollin në ferma për sigurinë ushqimore

Komisioni i Veprimtarive Prodhuese, Tregtisë dhe Mjedisit, diskutoi sot projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin “Për mbrojtjen e bimëve”.

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca, e pranishme gjatë diskutimit të këtij projektligji tha se, “përmes tij synojmë të rrisim kontrollin në fermë”.

“Të orientojmë fermerët tek agjencitë rajonale të ekstensionit, t'i edukojmë ata mbi protokollet që duhet të ndjekin në fermë dhe t'i japim Autoritetit Kombëtar të Mbrojtjes së Bimëve dhe Veterinarisë fuqinë ligjore që të shkojë e të kontrollojë sot në fermë, gjë që nuk e kanë deri tani”, u shpreh Krifca.

Kriaca shtoi se siguria ushqimore në vend është një çështje që po ndiqet me seriozitet në çdo hallkë, nga ferma deri në tavolinë.

“Me ndërhyrjet në vendimin e Këshillit të Ministrave, kemi eliminuar përdorimin e pesticideve që janë të palejuara në Europë. Po bëjmë të njëjtën gjë për produktet mjekësore veterinarë”, deklaroi Krifca.

Sipas saj, në Shqipëri importohen preparate vetëm sipas listës së BE-së. “Aktualisht po bëjmë një kontroll në të gjitha farmacitë bujqësore dhe depot që të garantojmë siguri të produk-

teve të mbrojtjes së bimëve bujqësore”, vijoi Krifca.

“Ajo që duam të bëjmë është që të kemi një nivel më të lartë të respektimit të protokolleve në fermë dhe t'i japim fuqinë e duhur autoriteteve”, theksoi ajo.

Ministrja informoi se për importet e produkteve të mbrojtjes së bimëve, merren paraprakisht paralajmërimet nga strukturat përkatëse dhe

hen inspektimit.

Inspektori i kontrollit fitosanitar është pjesë e grupit të punonjësve doganorë që marrin kontaktin e parë me mjetet që transportojnë bimë, produkte bimë, PMB dhe objekte të tjera.

Sipas projektligjit, ministri miraton me rregullore masat mbrojtëse kundër dëmtuesve të bimëve, teksa ndalohet importi, eksporti dhe kalimi tranzit



vlerësohen certifikatat fitosanitare nga vendet e originës dhe deri më sot nuk ka probleme nga importet.

Projektligji parashikon që importi dhe kalimi tranzit i bimëve, produkteve bimë dhe objekteve të tjera në territorin e Republikës së Shqipërisë bëhen në pikat kufitare të hyrjes ku funksionon kontrolli fitosanitar dhe i nënshtro-

i bimëve, produkteve bimë dhe objekteve të tjera, të infektuara me dëmtues karantinorë.

Gjithashtu, ndalohet importi dhe lëvizja e bimëve për mbjellje brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, nëse prania e dëmtuesve jokarantinorë të rregulluar ose simp-tomat e shkaktuara nga dëmtues jokarantinorë të rregulluar janë mbi kufijtë kritikë.

Një informacion i shkurtër se çfarë është GRASP

Praktikat e mira bujqësore nuk kanë të bëjnë vetëm me produktet; ato kanë të bëjnë edhe me njerëzit që punojnë në këtë sektor. Gazeta "Agrobines" po publikon në këtë numër një informacion të shkurtër rreth GRASP, për t'i lënë vendin një trajtimi më specifik nga ekspertët e fushës për këtë koncept të ri që nis të zbatohet edhe në vendin tonë sikundër aplikohet në vendet e tjera.

Ekspertët shprehën se GRASP është pikërisht standardi që i përkushtohet shëndetit, sigurisë dhe mirëqenies së punëtorëve të bujqësisë.

Kjo është arsyeja pse u esk-pertët zhvilluan GRASP - një GLOBALG.A.P.

GRASP do të thotë GLOBALG.A.P. që vlerëson në një farë mënyre rrezikun për sigurinë në fermë. Është një modul vullnetar, i gatshëm

për përdorim i zhvilluar për të vlerësuar praktikën sociale në fermë, të tilla si aspekte specifike të shëndetit, sigurisë dhe mirëqenies së punëtorëve.

Klasifikimi i rrezikut të vendit

Së bashku me Komitetin Teknik GRASP, GLOBAL G.A.P. Sekretariati ka zhvilluar një metodologji për vlerësimet e GRASP në versionin e ri të GRASP 1.3-1-i. Kjo metodologji bazohet në një koncept të klasifikimit të rrezikut që grupon vendet në tre kategori të ndryshme rreziku: i lartë, i mesëm ose i ulët. Kategoritë e rrezikut bazohen në Treguesit e Qeverisjes Botërore të Bankës Botërore (renditjet nga 1-100).

Harmonizimi i Praktikës së Mirë Sociale në mbarë botën

Kërkesat ligjore në lidhje me pikat e kontrollit (si paga

minimale, moshë e punësimit ligjor, orari i punës, etj.) ndryshojnë nga vendi në vend. Aty ku kërkesat janë më strikte, legjislacioni vendor ka përparësi ndaj GRASP. Aty ku nuk ka legjislacion (ose legjislacioni nuk është aq i rreptë), GRASP ofron kriteret minimale të pajtueshmërisë për një sistem të mirë të menaxhimit social.

Për t'i bërë këto kërkesa transparente për prodhuesit, audituesit dhe inspektorët, grupet lokale me shumë palë të interesuara zhvillojnë udhëzimet kombëtare të interpretimit të GRASP. GRASP mund të vlerësohet në çdo vend – edhe në vendet që nuk kanë ende një udhëzues kombëtar për interpretim. Mësoni më shumë rreth udhëzimeve kombëtare të interpretimit dhe aplikimit në Shqipëri në numrin e ardhshëm të gazetës “Agrobiznesi”.

Një limon kundër formimit të gurëve në veshka

Ngrënia e rregullt e limonëve parandalon formimin e gurëve në veshka. Limonët përmbajnë citrat që nuk lejon formimin e tyre. Shumë mjekë rekomandojnë terapinë e limonatës (ujit me limon) për trajtimin e gurëve.

Një limon kundër kolesterolit të keq

Limoni është i dobishëm

për uljen e nivelit të kolesterolit të keq. Flavonoidët që ai përmban janë armiq të kolesterolit të keq dhe triglicerideve. Ndaj nëse dëshironi të keni nivele të ulëta kolesterolit, mos iu ndani limonit.

Për mbrojtjen e trurit

Limoni mundet t'ju ndihmojë të mbani larg disa sëmundje të trurit siç është Alzheimer. Nëse siguroheni që nivelet ditore të vitaminës C janë optimale do të jeni më të mbrojtur kundër sëmundjeve të trurit.

KËSHILLA NË SHËRBIM TË FERMERËVE

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT TË BUJQËSISË, SIGURISË USHQIMORE DHE ZHVILLIMIT RURAL

QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE FUSHË KRUIJË

EFEKTET E SUPLEMENTIMIT TË DIETAVE ME YNDYRË SOJE NË PERFORMANCËN E LOPËVE TË QUMËSHITIT TË RACËS HOLSHTEIN

(Vijon nga gazeta paraardhëse)

Tab. Nr. 11 Të ardhurat dhe shpenzimet për 1 lopë/ditë

N/R	Emërtimi	Njësia matjes	Grupi Kontrollit (A)	Grupi Eksp. (B)	Diferenca (B-+ose-)
1	Prodhim qumështi	kg/krerë	27.9	31.91	4.01
2	Çmimi i shitjes	lek/kg	46	46	46
3	Të ardhurat	lek	1283.4	1467.86	184.46
4	Shpenzimet e ushqimit	lek	751.15	805.15	54
5	Të ardhura-Shpenzime (+ose-), Fitimi	lek	532.25	662.71	130.46

Përfundime

• Përdorimi i dietave ushqimore të ballancuara nëpërmjet suplementim-

Drejtorja e Teknologjive Blegtorale, QTTB-Fushë Krujë:
E-mail: qttbfushekruje@yahoo.com

qumështit.

Rekomandime

• Fermerët e fermave të qumështit duhet ti kushtojnë rëndësi të veçantë përdorimit të dietave ushqimore të ballancuara dhe të suplementuara me yndyrë për lopët me prodhimtari të lartë me qëllim për të minimizuar në maksimum balancën energjitike negative në 12 javët e para të laktacionit për të bërë të mundur që lopët të performojnë me kapacitet maksimal duke garantuar një rentabilitet të lartë të fermave të qumështit.

QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE FUSHË KRUIJË

DOMOSDOSHMERIA E PËRDITËSIMIT TË KATEGORIVE TË TOKËS NË NJËSITË ADMINISTRATIVE

Vreshtas, qarku Korçë

Kategoria e Tokës	Njësia administrative Pojan		Njësia administrative Vreshtas	
	Sipërfaqja/Ha		Sipërfaqja/Ha	
	Viti i regjistrimit	Viti i studimit	Viti i regjistrimit	Viti i studimit
Bujqësore	1996	2013	1998	2013
	5219.1	4831.2	5186.6	4498.4
Kullotë	93.8	290.6	10.9	710.2
Pyll	535.6	509.5	128	119.4
Jo bujqësore	858.7	1075.9	510.7	498.2

Të dhënat e mësipërme vërtetojnë edhe njëherë rritjen e sipërfaqes së kategorisë së tokës kullotë në të dy njësitë administrative dhe zvogëlimin e sipërfaqes së tokës bujqësore. Nga monitorimi në terren i këtij ndryshimi në rezultat, që toka bujqësore është kthyer në kullotë prej pjellorisë së ulët të tokës.

Po të analizojmë ndryshimet në kategorinë e tokës bu-

Drejtorja e Shërbimit të Tokës dhe Ujërave;
QTTB-Fushë Krujë: E-mail: qttbfushekruje@yahoo.com

jqësore në njësinë administrative Pojan nga 97% e sipërfaqes së tokës që zë toka arrë në vitin 1996 zvogëlohet në 89% në vitin 2013. Gjatë këtyre viteve konstatohet që është rritur sipërfaqja e tokës me dru frutorë në masën 11%. Ndërsa në njësinë administrative Vreshtas nuk ka ndryshim të dukshëm në sipërfaqen e tokës arë.

Analiza e mësipërme e përdorimit të tokës në këto njësi administrative i referohet periudhës 1996 – 2013. Pyetja shtrohet nëse është kryer përditësimi i informacionit për ndryshimet në kategoritë e tokës apo ndryshimet në kategorinë e tokës bujqësore pas kësaj periudhe në këto njësi administrative apo në njësinë administrative në shkallë vendi?

Nga Drejtorja e Shërbimit të Tokës dhe Ujërave në QTTB Fushë-Krujë nëpërmjet Programit "Menaxhim i Qëndrueshëm i Tokës Bujqësore" është mundësuar dixhitaliz-

imi i regjistrimit të tokës bujqësore dhe kategorive të tjera të resersuve në këto njësi administrative ose në 65% të njësive administrative në shkallë vendi.

Regjistri dixhital lehtëson shumë përditësimin e këtij informacioni, por kërkohet përgjegjësi nga specialistët e Zyrate të Menaxhimit të Mbrojtjes së Tokës në njësinë administrative në zbatimin e udhëzimit Nr. 11 datë 14.06.2011 "Për mënyrën e verifikimit dhe të ndryshimit të zërave kadastralë të tokës bujqësore", ku në mënyrë eksplicite detyron specialistët e ZMMT të bëjnë përditësimin çdo vit të përdorimit të tokës.

Një sistem i përditësuar është i vlefshëm për fermerët duke iu dhënë informacion, që të investojnë në produkte që janë të kërkuar në treg, për politikën e MBZHR një situatë reale që të adresojë skemat mbështetëse në drejtimin e duhur, në ofrimin e të dhënave në funksion të vjetarit statistikor etj.

Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore në zbatim të detyrave që ngarkon VKM 515 është e gatshme të ofrojë edhe njëherë trajnime të specialistëve të ZMMT në njësinë administrative mbi përditësimin e ndryshimeve të përdorimit të tokës bujqësore dhe kategorive të tjera të resurseve.

Përgatitën: Suada Luzati, Përgjegjësi i Sektorit të Hartografisë dhe i Përdorimit të Tokës

Eriola Veselaj, specialiste në Sektorin e Hartografisë dhe të Përdorimit të Tokës.

QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE LUSHNJË

KUJTESË KËSHILLUESE PËR FERMERËT QË KANË MBJELLË GRURË PËRKUJDESJET NDAJ BIMËVE

Proceset biologjike tek bima e grurit ashtu si dhe bimët e tjera janë të parikthyeshme. Kjo do të thotë se një proces ndodh vetëm një herë. Po qe se bimës gjatë ndodhjes së këtij procesi biologjik i plotësohen në rregull të gjitha nevojat për ujë ajër, dritë, nxehtësi dhe ushqim, atëherë ajo shpreh aftësinë e saj maksimale prodhuese. Po qe se ndonjëra nga kërkësat e mësipërme asaj i mungon dhe bima vuan, atëherë mungesa do të lërë gjurmë në jetën e saj. Efekti i këtyre gjurmëve, edhe kur është i pakapshëm nga syri i njiut, përsëri i jep goditje prodhimit të ardhshëm, i cili ulet.

Nga ky kushtëzim biologjik, veçanërisht për marrjen e rendimenteve të larta në grurë fermerëve u del nevoja, që përkujdesjet ndaj bimëve si kullimi, plehërimi, luftimi i barërave të këqija etj, të kryhen të palota në kohën e duhur dhe me cilësi të lartë.

KULLIMI

Marrja e rendimenteve të larta në grurë është e kushtëzuar me sigurimin e një regjimi të përshtatshëm ujqor në tokë nga mbjellja deri në pjekje. Po qe se ky regjim do të prishet nga teprica e ujit në tokë pasojat do të jenë shumë të rënda: rrënjët mbeten në sipërfaqe e nuk zhvillohen në thellësi, prishet aktiviteti mikrobiologjik, ulet koeficienti i shfrytëzimit të plehrave, toka ngjshet prishet struktura e saj etj. Bimet zhvillohen të dobëta e të zverdhura dhe në rastin e ndonjë thatësire nuk e durojnë dot ate, si pasojë rendimenti ulet. Në kushtet e këtij viti bujqësor me reshje relativisht të shumta është e rekomandueshme për të gjitha zonat ekologjike ku kultivohet gruri, organizimin e disa masave të forta për kullimin e tokave ku është mbjellë

kjo bimë, si në fushë në kodër në tokat e pjerrta e kudo, për kushtet e vendit tonë kullimi është vendimtare për marrjen e rendimenteve të larta.

Në kompleksin e masave për kullimin e tokave të grurit me kryesoret janë:

- Zgjedhja e sistemit të punimit të përshtatshme të tokës që për mbjelljet e vjeshtës duhet mbyll (skolinazhi me kuriz). Nivelimi shumë i mirë sipërfaqësor i saj.

- Drenazhimi i përkohshëm (urith) ose i përhershëm nëntokësore. Distanca e drenave varet nga përbërja mekanike e tokës 2 deri 4 metra, dhe në një thellësi 15-20 cm, më shumë se plugimi i tokës.

- Hapja e vijave kulluese sipërfaqësore kur toka është e pluguar me sistemin kuriz ato hapen në vendin më të ulët aty ku mbyllet skolina. Largësia e tyre varet nga përbërja mekanike e tokës ku ajo shkon nga 16 metra deri në 32 metra gjerësi, por në vendin tonë ato zakonisht bëhen 23 metra gjerësi. Thellësia e vijave kulluese duhet të jetë në zonat kodrinore malore ato hapen 40-50cm, për zonat fushore ato hapen 60-70cm. Zakonisht vijat kulluese derdhen në kanalim e tretë kullues që kufizon me parcelën ku është mbjellë gruri por ato mund të derdhen edhe në një

kryebrazdë të hapur enkas për këtë qëllim. Vijat në kushtet e sotme hapen me traktor pastrohen nga dherat, por ato mund të hapen edhe para mbjelljes. E rëndësishme për fermerin i cili kultivon bimën e grurit është që sistemi i kullimit në parcelën e tij të jetë gjithmonë funksional gjatë të gjithë ciklit bimor të bimës së grurit. Fermeri i kujdesshëm gjithmonë pas rënies së shirave kontrollon parcelën e tij me grurë, që të mos ketë asnjë problem me kullimin sidomos ujërat sipërfaqësore.

- PLEHËRIMI PLOTËSUES (GJATË VEGJETACIONIT)

- Gjatë ciklit bimorë pas mbirjes bima e grurit kërkon të ushqehet kryesisht me plehra azotike. Ato i jepen bimës në formën e nitrarit të amonit ose të uresë, sulfatit të amonit ose plehut të lëngshëm, por kur është mundësia gjatë vegetacionit përdoret edhe plehërimi me anë të spërkatjes gjetore.

- Kriteret kryesore të plehërimit plotësues azotik të grurit janë si më poshtë:

- Sasia më e madhe e plehut hidhet pak më përpara se bima të realizojnë rritjen intensive të saj.

- Për tokat e lehta më kompleks thithës të dobët e njëjta sasi hidhet në më shumë duar se ato të rënda.

Sektorin e Grurit: QTTB-Lushnjë
E-mail: qttblushnje@yahoo.com

- Në vite me dimër e pranverë të lagësht e njëjta sasi hidhet në më shumë duar dhe me doza me të vogla, se sa kur moti është me kushte normale.

- Në kushtet e lagështisë përdorimi i uresë ka më shumë efektivitet se nitrati.

- Në kushtet kur ka thatësi sidomos gjatë vllazërimit rekomandohet plehërimi i lëngshëm.

- Doza dhe sasia e plehut plotësues që do të hidhet janë të përcaktuara në bilancin e grurit në bazë të pjellorisë së tokës, rendimentit të planifikuar dhe kërkesave që ka secili kultivar ose lloje gruri. Plehërimi plotësues tek gruri bëhet në 3-5 duar. Sasia që duhet të hidhet është 30 deri në 50kg/dy, e shpërndarë kjo sasi sipas fazave të zhvillimit të bimës së grurit, p.sh. gjatë fazës së vllazërimit mund të hidhet dora e I deri në 25% të sasisë së planifikuar, gjatë fazës së para të ngritjes hidhet 25-30% dora e II, gjatë fazës së ngritjes masive që i bie dora e III hidhet 30% e sasisë të planifikuar, gjatë fazës së kallzimit hidhet 20% e sasisë të planifikuar që i bie të jetë dora e IV, në këtë moment mbaron hedhja e plehërimit plotësues. Shërbime të tjera për kulturën e grurit gjatë vegetacionit deri në pjekje janë:

- LUFTIMI I BARËRAVE TË KËQIJA, prania e tyre në parcelë ka ndikim negativ për kulturën e grurit, si rezultat prania e tyre ul rendimentin në 15-20%. Rrugët e luftimit janë parandaluese (qarkullimet bujqësore), kimike me spërkatje dhe mekanike të harra me dorë, rol të mirë luan edhe zgjedhja e parabisës në qarkullimin bujqësor, parabisët prashitëse dhe kulturat bishtajore janë klturat më të mira që e lënë tokën të pastër nga infeksioni nga barishtet e këqija.

KËSHILLA NË SHËRBIM TË FERMERËVE

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT TË BUJQËSISË, SIGURISË USHQIMORE DHE ZHVILLIMIT RURAL

QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE KORÇË

Për fermerët e dheneve:

- Krijoni ambiente të ngrohta dhe të thata për delet dhe sidomos për qingjat. Këto ambiente sigurohen duke ndërrhyrë në stallë për të evituar korentet e ajrit dhe ndikimin e temperaturave të ulta nga jashtë.
- Siguroni shtresë të thatë duke përdorur sa më shumë kashtë.
- Në delet e pjella krijoni boks për të ushqyer qingjat me ushqime voluminoze dhe Koncentrate.
- Kontrolloni delet nga gjiri, kujdes për delet që kanë sëmundje të gjirit, në rast konstatimi bëni mjekimin sipas këshillave të veterinerit.
- Vëzhgoni qingjat që sëmuren nga sëmundja e mishit të bardhë (bllokim të gjymtyrëve, mos qëndrim në këmbë, paraliza etj). Qingjat e sëmurë mjekojini me Vit E + Selen, Këshillohu me veterinerin për dozat

KËSHILLA PËR FERMERËT QË MBARËSHTOJNË BAGËTI TË IMTA

e trajtimit.

- Temperaturat në gradë celcius për fermat që mbarështojnë bagëti të imta në zona malore (mbi 750 m mbi nivelin e detit) duhet të jenë në ambientet stallore minimumi 180 celcius dhe maksimumi 220 celcius. Këto kritere të strehimeve sigurohen edhe me përdorimin (në

këto zona të ftohta) të kaloriferëve dhe të llampave infra të kuqe të instaluar në stalla.

Për fermerët e dhive:

Jemi në periudhën që dhitë janë në fazën e dytë të barsmërisë, para pjelljes prandaj ju këshillojmë:

- Krijoni kushte optimale strehimi (temperatura jo më e ulët se 120C, lagështia relative e ajrit 70-80 %, (nuk ndihet era e amoniakut me nuhatje dhe qimet e kafshëve duhet të jenë të thata).

- Trajtohen dhitë me ushqime cilësore tre javë para pjelljes: bar jonxhe cilësi e mirë plus bar kullote i thatë sipas dëshirës dhe ushqim i koncentruar 200-400gr në ditë në vartësi të prodhimit të pritsëm të tyre. Sigurohet ujë i pastër sipas dëshirës dhe jepen çdo ditë 8-10gr kripë gjelle. Më mirë është përdorimi i blloqeve të kripës në formë mineralo-vitaminaze sipas dëshirës së kafshës (pra add libidium).

- Kujdes të madh bëni në kullotjen e dhive. Mos i nxirni në kullotë në ditë me ngrica dhe brymë sepe shkaktohen dështime mekanike.

Drejtorja e Teknologjive Blegtorale: QTTB- Korçë: E-mail: qttbkorce@yahoo.com

QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE VLORË

Krasitja dimërore në hardhi:

- Një thënie e vjetër për vreshtarinë e mjaft e rendësishme për krasitjen e saj është "Të më punojë kush të dojë, por të më krasitë imzot".
- Krasitja si koncept: është një tërësi operacionesh për të pakësuar një pjesë të kurorës që tashmë ka frutifikuar dhe detyrojmë pjesën tjetër për zhvillim vegetativ dhe prodhim.
- Qëllimet kryesore të krasitjes:
 - Realizohet një formë e stabilizuar e hardhisë lidhur me: -Pjellorinë e tokës, -Kushtet klimatike si dhe -Tipi i vreshtit.
 - Vendoset një raport i drejtë midis masës vegetative dhe prodhimit.
 - Disiplinohet zhvillimi në pjesë të ndryshme të bimës.
 - Realizohet ekuilibri i nevojshëm bimë-tokë për marrjen e prodhimeve konstante vjetore.
 - Zgjatet jeta e hardhisë
 - Eleminohen pjesët e sëmura, të thata e gjithçka e tepërt ose e dëmshme.
 - Favorizon qarkullimin e ajrit, depërtimin e dritës e ngrohtësisë.
 - Lehtëson luftimin e sëmundjeve e dëmtuesve dhe shërbimet agroteknike.
 - Garantohet cilësia e prodhimit.
 - Si përfundim: Realizohet ekuilibri i domosdoshëm biologjik midis pjesës ajrore dhe asaj nëntokësore të bimës, i cili kompletëhet dhe mbyllet përfundimisht me operacionet e gjelbëra (krasitja verore) si vazhdim i krasitjes dimërore.

Pse krasitja është një e keqe e domosdoshme?
E keqe: Sepse prish raportet e vendosura gjatë vitit vegetativ midis bimës dhe tokës.
E domosdoshme: Për të gjitha arsyt e renditura më sipër

Llojet e krasitjes

Nga pikpamja e moshës ndahen: -Krasitje formuese -Krasitje prodhuese-Krasitje ripërtëritëse Krasitje të veçanta (nga ngrica, breshëri, kanceri etj.)

Qëllimi i krasitjes formuese:

Krijimi i një trupi të drejtë mbi të cilin shpërndahen elementët e prodhimit në vitet që pasojnë.

Teknika e kryerjes:

Në vitin e parë pas mbjelljes (janar të vitit pasardhës të mbjelljes) paraqiten disa raste nga pikpamja e fuqisë së bimës:

1- Kur 1 ose 2 lastarë të çelur, gjatë vëgjetacionit, kanë patur zhvillim të dobët duke arritur gjatësinë e pjesës së pjekur jo me shumë se 30-40 cm dhe trahësi 3-4 mm. Në këtë rast krasitja bëhet duke lënë vetëm 1 lastar me 2-3 sytha të pjekur e të pa dëmtuar.

2- Kur lastari ka gjatësinë të konsiderueshme deri në 1m, por mjaft i hollë (4-5mm) Edhe në këtë rast krasitja bëhet duke lënë vetëm 2 sytha (lënia e një lastari të gjatë, por të dobët, do të krijonte mundësinë e një zhvillimi të madh gjatë vëgjetacionit të 1-2 lastarëve të bazës, duke mos shfrytëzuar dot vitin e dytë, gjatësinë e arritur vitin e parë).


3- Kur lastari në fund të vëgjetacionit të vitit të parë ka

TEKNIKAT E KRASITJES DIMËRORE TË HARDHISË


arritur gjatësinë e pjesës së pjekur mbi 1m dhe trashësinë mesatare rreth 9-10 mm: në këtë rast krasitja bëhet duke lënë në qysh vitin e parë lastarin e zhvilluar (që do të jetë trugu i ardhshëm i bimës) në gjatësinë e shtrirjes së telit bazë plus 3-5 sytha (që do të jenë fillesa e kordonit bazë). Lënia e më shumë sythave, në këtë rast, do të sillte për r shkak të fenomenit të polaritetit në hardhi, mosçelje të sythave të bazës, e si pasojë problem të formimit të një kordonit tekniksht të rregullt. Sythat nën lartësinë e telit bazë qorrohen të gjithë gjatë procesit të krasitjes.

4- E rëndësishme është që për formimin e një trugu të drejtë e pa deformime, qysh vitin e parë të vendosen hunj mbështetës, pas të cilit do të lidhet, gjatë vëgjetacionit, lastari më i zhvilluar.

tin e tretë këta lastarë largohen plotësisht nëpërmjet krasitjes dimërore.



Në vitin e tretë. Kemi krijuar të dy krahë të kordonit, në rastin e kordonit bilateral, ose kordonin e plotë (deri në distancë në kufirin me bimën fqinje), në rastin e kordonit të njëanshëm. Në lastarët që kanë shpërthyer gjatë vëgjetacionit mbi krahët e kordonit,



lihen në çdo 20-25 cm, çepa me 2 sytha, në lastarë të cilëve vitin e katërt e më pas, realizohen format e dëshiruara të krasitjes. Është për t'u theksuar fakti që në bimë të ndryshme të të njëjtit vreshtë, (mbi bazë të zhvillimit individual të çdo bime) kryhen krasitje të ndryshme me karakter formimi në të njëjtin vit, në përshatje me vetë bimën.

Krasitja prodhuese

Qëllimi: Krijimi i ekuilibrit të drejtë vëgjetativo-produktiv. Realizohet nëpërmjet 3 sistemeve të krasitjes prodhuese:

-Sistem i krasitjes së shkurtër, (Të dy elementët, si të zëvendësimit dhe të prodhimit, përfaqësohen nga lastarë me 2-3 sytha), (format më të njohura e të përdorura: Kordon Roaja dhe forma Kupore).

- Sistem i krasitjes së gjatë, Në bimë ndodhen vetë m lastarë me jo më pak se 7-8 e më shumë sytha, pa praninë e çepave me 2-3 sytha. Format më të njohura e më të përdorura: (Sylvoz dhe Kazarsa e një dhe dy anëshme, etj).

- Sistem i krasitjes së përzier: Kombinim i të dy sistemeve (ndeshen element të çepave me 2-3 sytha, si dhe elemente prodhimi me sharmenda me 7-8-12-16 sytha, në vartësi të faktorëve të tjerë. Format më të njohura:

Para krasitjes së shkurtër, fig.1



Pas krasitjes së shkurtër, fig.2



Krasitje e shkurtër, forma Kordon Roaja me çepa, Fig.3

QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE VLORË

Gyo (mono dhe dopio), Kaznav, Kurriz peshku, etj.

Përgatiti: Llambro Dhima

(Vijon në numrin e ardhshëm)

KËNDI I EKSPERTIT

(Vijon nga faqja 14)

Kalendari bujqësor, muaji janar 2022

dhe në fazat e Hënës dhe marrëdhënies të tyre me shënjat e Zodiakut.

Kalendari i ditëve më të mira të muajit janar 2022 për disa aktivitete të përditshme të fermerit

Data	Punët dhe aktivitetet që mund të kryhen
1	Trajnime të shkurtra, zvjerdhja e fëmijëve dhe të të vegjëlve të kafshëve, Kositje e barit në lëndina për të ngadalësuar rritjen e tij, Krasitje e pemëve, Kastrimi i kafshëve,
2	Për të gatuar, Prerja e flokëve për të nxitur rritjen e tyre, Trajnime të shkurtra, Lyerja me dyllë e dyshemeve prej druri dhe parketit, Zvjerdhja e fëmijëve dhe të të vegjëlve të kafshëve, Kastrimi i kafshëve, Prerja e druve të zjarrit, Hapje e gropave për mbjelljen e pemëve, Kositje e barit në lëndina për të nxitur rritjen e tij, Shkohet për peshkim, Prerja transportim trupash,
3	Trajnime të shkurtra, zvjerdhja e fëmijëve dhe të të vegjëlve të kafshëve, Kastrimi i kafshëve, Prerja e druve të zjarrit, Hapje e gropave për mbjelljen e pemëve, Kositje e barit në lëndina për të nxitur rritjen e tij, Mbahet një festë ose parti, Lyerje me gëlqere dhe ngjyra, Luftimi i dëmtuesve të bimëve, Shkohet për peshkim, Prerja transportim trupash,
4	Trajnime të shkurtra, zvjerdhja e fëmijëve dhe të të vegjëlve të kafshëve, Kastrimi i kafshëve, Prerja e druve të zjarrit, Hapje e gropave për mbjelljen e pemëve, Kositje e barit në lëndina për të nxitur rritjen e tij, Mbahet një festë ose parti, Lyerje me gëlqere dhe ngjyra, Luftimi i dëmtuesve të bimëve, Shkohet për peshkim,
5	Trajnime të shkurtra, Prerja e flokëve për të nxitur rritjen e tyre, Lyerja me dyllë e dyshemeve prej druri dhe parketit, zvjerdhja e fëmijëve dhe të të vegjëlve të kafshëve, Kastrimi i kafshëve, Prerja e druve të zjarrit, Hapje e gropave për mbjelljen e pemëve, Kositje e barit në lëndina për të ngadalësuar rritjen e tij, Fillimi i dietës për të shtuar në peshë, Bëhen martesat, Shkohet për peshkim,
6	Trajnime të shkurtra, Prerja e flokëve për të nxitur rritjen e tyre, Lyerja me dyllë e dyshemeve prej druri dhe parketit, zvjerdhja e fëmijëve dhe të të vegjëlve të kafshëve, Kastrimi i kafshëve, Prerja e druve të zjarrit, Hapje e gropave për mbjelljen e pemëve, Kositje e barit në lëndina për të nxitur rritjen e tij, Fillimi i dietës për të shtuar në peshë, Bëhen martesat, Shkohet për peshkim, Përgatitja e reçelit dhe brevede,
7	Trajnime të shkurtra, Prerja e flokëve për të nxitur rritjen e tyre, Lyerja me dyllë e dyshemeve prej druri dhe parketit, zvjerdhja e fëmijëve dhe të të vegjëlve të kafshëve, Kastrimi i kafshëve, Prerja e druve të zjarrit, Hapje e gropave për mbjelljen e pemëve, Kositje e barit në lëndina për të nxitur rritjen e tij, Fillimi i dietës për të shtuar në peshë, Bëhen martesat, Përgatitja e reçelit dhe brevede,
8	Për të gatuar, Prerja e druve të zjarrit, Hapje e gropave për mbjelljen e pemëve, Kositje e barit në lëndina për të nxitur rritjen e tij, Luftimi i dëmtuesve të bimëve,
9	Për të gatuar, Prerja e druve të zjarrit, Hapje e gropave për mbjelljen e pemëve, Kositje e barit në lëndina për të nxitur rritjen e tij, Luftimi i dëmtuesve të bimëve,
10	Prerja e flokëve për të nxitur rritjen e tyre, Lyerja me dyllë e dyshemeve prej druri dhe parketit, Prerja e druve të zjarrit, Hapje e gropave për mbjelljen e pemëve, Kositje e barit në lëndina për të nxitur rritjen e tij, Lyerje me gëlqere dhe ngjyra, Bëhen martesat, Studiohet tregu për shitjen e prodhimeve, Për të blerë rroba, Studimi i tregut për shitjen e prodhimeve bujqësore,
11	Prerja e flokëve për të nxitur rritjen e tyre, Lyerja me dyllë e dyshemeve prej druri dhe parketit, Prerja e druve të zjarrit, Hapje e gropave për mbjelljen e pemëve, Kositje e barit në lëndina për të nxitur rritjen e tij, Studimi i tregut për shitjen e prodhimeve bujqësore, Kryhen martesat, Blihen veshje,
12	Fillon dieta për të shtuar në peshë, Takime me miqtë, Udhëtime për qejf, Për të shkruar,
13	Mbahet një festë ose një parti, Takime me miqtë, Udhëtime për qejf, Për të shkruar,
14	Mbahet një festë ose një parti, Për të shkruar,
15	Për të gatuar, Lyerja me dyllë e parketit dhe dyshemeve prej druri, Shkohet për peshkim, Kryhen martesat,
16	Për të gatuar, Lyerja me dyllë e parketit dhe dyshemeve prej druri, Shkohet për peshkim, Kryhen martesat,
17	Shkohet për peshkim, Kryhen prishje dhe shkatërrime, Lyerje me gëlqere dhe me ngjyra, Lahen dyshemetë prej druri, Takime me miqtë,
18	Shkohet për peshkim,
19	Shkohet për peshkim,
20	Shkohet për peshkim,
21	Shkohet për peshkim,
22	Fillon dieta për të rënë nga pesha, Lënia e pirjes së duhanit,
25	Përgatitja e pijeve alkoolike, Konservimi në kuti dhe përgatitja e turshive i frutave dhe perimeve, Ndërzimi i kafshëve,
26	Fillon dieta për të rënë nga pesha, Përgatitja e pijeve alkoolike, Konservimi në kuti dhe përgatitja e turshive i frutave dhe perimeve, Lënia e pirjes së duhanit, Ndërzimi i kafshëve,
27	Tharja e frutave, perimeve dhe mishit,
28	Tharja e frutave, perimeve dhe mishit,
29	Shkohet për peshkim, Prerja transportim trupash,
30	Shkohet për peshkim, Prerja transportim trupash,
31	Shkohet për peshkim, Kastrimi i kafshëve,

Kalendari i Ditëve më të mira të muajit Janar 2022 për disa aktivitete të përditshme të fermerit

Jeta dhe veprimtaria e njerëzve duhet të zhvillohet në harmoni të plotë me natyrën dhe ky është çelësi me të cilin mund të zbulohen bukuritë e jetës. Në këtë drejtim është e rëndësishme të kuptojmë parimin e thjeshtë se rendi natyror i gjërave është një grumbull i proceseve ritmike të përsëritura që ndikojnë shëndetin tonë, forcën fizike dhe gjëndjen shpirtërore. Mekanizmat që funksionojnë në natyrë ndikojnë në qënien njerëzore, e cila është pjesë përbërëse e botës që na rrethon. Për të kuptuar më mirë realitetin rreth

nesh dhe për të përshtatur ritmin e punës dhe të jetës sonë, duhet të kemi njohuri të mjaftueshme për këto fenomene, të cilat kanë ndikimin më të madh në këto procese.

Hëna ndikon jo vetëm në rritjen dhe zhvillimin e bimëve por dhe në veprimtarinë jetësore dhe të përditshme të qënjeve të gjalla. Sipas traditës mendohet se kur hëna është në fazën e duhur dhe vendin e duhur në zodiak, behohet gjërisht se aktivitetet do të jenë më të frytshme apo të çojnë në rezultate të mira. Periudha në mes të hënës së re dhe të plotë (çereku i parë dhe i dytë i hënës), konsiderohet si koha më e mirë për të kryer detyrat që kanë lidhje me forcën, pjellorinë dhe rritjen. Periudha mes Hënës së plotë dhe hënës së re (çereku

i tretë dhe i katërt i hënës), është koha më e mira për korrigjime, rritjen e ngadalësuar, etj. Merret në konsideratë edhe për marrëdhënien që ka hëna me 12 shënjat sunduese të zodiakut. Kështu në bazë të kombinimeve dhe marrëdhënies të Hënës me trupat qiellorë që shprehen në shënjat zodiakale, përcaktohet në një farë mase ndikimi dhe rezultati i këtyre veprimtarive.

Kalendari hënor i të ushqyerit të njerzve për muajin Janar 2022

Në këtë pjesë jepen rekomandime për ushqimin e përditshëm të njerzve, duke patur parasysh drejtimit kryesor të ushqimit ditor të njeriut. Kjo bëhet duke u bazuar

Kalendari hënor i të ushqyerit të njerzve për muajin janar 2022

Dt.	Përshkrimi i të ushqyerit gjatë ditës
1	Merrni vetëm ushqim vegjetarian këtë ditë. Drithërat dhe farat janë të favorshme. Prodhimet e qumështit mund të kenë një efekt të favorshëm. Përgatitni byrekë të bërë në shtëpi, petulla etj.
2	Është më mirë të pushoni gjatë kësaj dite të fundit të muajit hënor. Merrni më shumë perime dhe fruta, Përgatisni ushqim delikat. Jepini vetes një kënaqësi me ëmbëlsirat. Rekomandohet një dietë vegjetariane. Shmangni ushqimet e nxehta, pikante, të majme. Çaji i fortë, kafeja ose alkooli nuk rekomandohet.
3	Këto ditë mund të bëni një listë të ushqimeve të përshtatshme. Shikoni reagimin për çdo ushqim që merrni. Nëse ju pëlqen një ushqim i caktuar - ju përshtatet, përndryshe mos e merrni. Në përgjithësi, preferoni ushqime delikate. Agjërimi i thatë lejohet. Shmangni mishin dhe alkoolin.
4	Lejohet ushqimi pikant dhe mishi. Mund të përdorni erëza si xhenxhefil, djegës, karafil, mustardë, etj. Merrni ushqim të larmishëm, të freskët dhe të shëndetshëm. Shmangni ngrënien e tepërt, përndryshe, çdo ushqim i tepërt mund të çojë në shtimin e peshës.
5	Preferohen ushqime delikate dhe të konsiderueshme si ragu me perime, sallata, perime të ziera. Çaji bimor qetësues mund të sjellë një efekt të favorshëm. Përdorni melissa, kamomil dhe nenexhik. Bëni një brumë buke për byrekë me bukë dhe krem. Gjatë këtyre ditëve yndyra ka cilësinë e saj më të mirë, që ndikon në mënyrë të favorshme mbi gjëndrat. Nëse keni probleme me sistemin endokrin, shikoni se çfarë dëshironi të hani. Ndoshta jo të gjitha janë të shëndetshme për ju. Ndryshoni racionin tuaj ushqimor. Merrni ushqim të larmishëm, të freskët dhe të shëndetshëm. Shmangni ngrënien e tepërt, përndryshe, çdo ushqim i tepërt mund të çojë në nxjerrjen e mishit.
6	Kujdes veçanërisht me ushqimin sepse kjo ditë simbolizon fillimin e tretjes dhe transformimit të ushqimit që merrni. Kjo është dita e vetme kur ushqimi digjet dhe shndërrohet plotësisht në inde. Ndiqni instinktin tuaj kur zgjidhni ushqimin. Bëni shumë ushqime të ndryshme dhe hani atë që doni. Mos e teproni, jini të kënaqur. Qumështi dhe gjiza janë ushqimi më i mirë i kësaj dite. Preferohen frutat dhe mjalti. Mos agjëroni, shmangni mishin, arrat, lakrën e fermentuar, miellin, drithërat, farat, ushqimet e papërpunuara dhe alkoolin. Ndoshta jo të gjitha janë të shëndetshme për ju. Ndryshoni racionin tuaj ushqimor. Merrni ushqim të larmishëm, të freskët dhe të shëndetshëm. Shmangni ngrënien e tepërt, përndryshe, çdo ushqim i tepërt mund të çojë në nxjerrjen e mishit.
7	Ushqimi i përgatitur i freskë luan një rol të rëndësishëm sot. Bajameja e pjekur është e preferuar. Produktet e kripura janë të lejueshme. Mos merrni ushqim të ëmbël dhe të hidhur. Pini më pak ujë
8	Merrni vetëm ushqim të freskët dhe cilësor. Ushqimi pikant, i nxehtë dhe kreshmor, perimet dhe pemët e freskëta, qulli dhe çaji bimor janë shumë të mira. Shmangni çajin e fortë, kafënë, alkoolin. Merrni fasule, elb dhe fasule kokërmadhe. Mos merrni mollë, lakër, hudhër, vezë dhe perime të gjata. Lejohet speci i kuq, boronicë, manaferra e kuqe, hithra dhe brevede shtëpiake.
9	Ushqimi duhet të jetë i konsiderueshëm, por jo i tepërt. Shmangni mishin, kërpudhat, bimët bishtajore. Gjatë kësaj dite hënore gjaku rigjenerohet, kështu që përdorni shafran i Indisë. Pija më e mirë është çaji me shafran i Indisë. Në mbrëmje, jo shumë para se të flini, pini qumësht me shafran i Indisë dhe kopër. Idealisht merrni fruta, perime, supë delikate dhe qull. Peshku lejohet.
10	Ushqimi duhet të jetë i konsiderueshëm, por jo i tepërt. Shmangni mishin, kërpudhat, bimët bishtajore. Gjatë kësaj dite hënore gjaku rigjenerohet, kështu që përdorni shafran i Indisë. Pija më e mirë është çaji yoga me shafran i Indisë. Në mbrëmje, jo shumë para se të flini, pini qumësht me shafran i Indisë dhe kopër. Idealisht merrni fruta, perime, supë delikate dhe qull. Peshku lejohet.
11	Kjo ditë është për llupsat, por mos e teproni. Është e rëndësishme të përgatisni diçka të veçantë, të pazakontë, të shijshme. Koha më e mirë për eksperimente. Lejohet çdo lloj ushqim dhe verë e kuqe. Frutat e rrushit dhe ato ekzotike janë shumë të favorshme.
12	Produkti kryesor është arra. Shmangni mishin dhe pijet e forta. Lejohet vera e kuqe. Në përgjithësi, dita ideale për shkarkimin e trupit tuaj. Merrni më shumë vaj vegjetal.
13	Mbani dietë dhe merrni ushqim delikat. Çdo mbingarkesë mund të çojë në pasoja të dëmshme. Ushqimi më i mirë për këtë ditë është shega, perime të rrumbullakëta, lakra dhe patatja. Shmangni perimet e gjata si karotën, kungulleshkën, kastravecjin, patëllxhanin, etj.
14	Merrni çdo ushqim që ju pëlqen përveç mishit. Preferohet të eksperimentoni me receta të reja ekzotike. Gjëja kryesore është që ushqimi duhet të përgatitet i freskët.
15	Këtë ditë produktet e kuqe rekomandohen si shegë, boronicë, panxhar, karrota, qersh, qersh të kuqe dhe lëngje të shtrydhura freskët. Pini çaj për pastrimin e gjakut. Merrni çdo ushqim që ju pëlqen, por mos mbingarkoni më tej dhe mos mbingarkoni me ëmbëlsira të tepërta.
16	Lejohet çdo lloj ushqimi. Ganesha, një epikaturë e njohur, është një mbrojtës për këtë ditë. Hani shumë sot. Përgatitni gatimet e kuzhinës tradicionale indiane si Laddu, khir. Ushqimi i perimeve është i favorshëm. Agjërimi nuk rekomandohet.
17	Mbingopja është e rrezikshme këtë ditë. Qumështi i fermentuar dhe produktet e qumështit janë të favorshme. Menyja më e mirë është byrek me qumësht dhe kremkaramel me arra. Shmangni mishin, kafënë dhe alkoolin. Mbingopja e tepërt mund të çojë në probleme të traktit të tretjes. Merrni më pak ujë. Lejohet agjërimi.
18	Këtë ditë ushqimi duhet të jetë i larmishëm dhe ushqyes. Qumështi i fermentuar dhe produktet e qumështit janë të favorshme. Lejohet pak verë e thatë. Agjërimi nuk rekomandohet.
19	Një ditë e mirë për pastrimin. Rekomandohet agjërimi. Mos pini shumë. Shmangni ushqimet e forta. Kërpudha dhe pjeper nuk rekomandohen. Merrni prodhime të qumështit, veçanërisht gjizë, por jo shumë. Lakrorët me mbushje janë të favorshme.
20	Kjo ditë është e ndërlukuar energjikisht. Është e favorshme të marrësh ushqim delikate me perime. Shmangni fasulet. Shpesh kjo ditë është njëkohësisht me Ekadashi. Gjatë Ekadashi shmangni marrjen e vajrave të grurit dhe bimëve. Bëni një darkë nga sallata me hirkra dhe perime. Në mbrëmje pini qumësht. Përdorni gjalpë të shkrirë. Mos merrni perime të rrumbullakëta. Patatja, peshqit dhe barishte lejohen. Lejohet agjërimi.
21	Merrni ndonjë ushqim që ju pëlqen, por mos e teproni, kryesisht mish. Përdorni erëza kur përgatisni ushqim me yndyrë. Preferohet të përdorni kardamom, shafran i Indisë, hudhër, piper. Shmangni pataten dhe agrumet. Byrek me krem është i favorshëm. Nëse është e nevojshme filloni agjërimin. Mos pini shumë.
22	Përdorni jeshillëqet me çdo ushqim të ngurtë që merrni sot. Arrat janë të favorshme. Mos harroni të pini lëngje, hani fruta dhe perime. Rekomandohet agjërimi i thatë. Shmangni farat, kokrrat dhe ushqimin për kafshët.
23	Merrni vetëm ushqim vegjetarian këtë ditë. Drithërat dhe kokrrat janë të favorshme. Prodhimet e qumështit mund të japin efekt të favorshëm. Përgatitni lakrorë, kekëetj.
24	Ditët e dritës. Elementi aktiv është ajri. Pjesa korresponduese e bimës për atë Shenjë është lulja. Gjatë këtyre ditëve yndyra duhet të ketë cilësinë e tij më të mirë, që ndikon në mënyrë të favorshme te gjëndrat. Nëse keni problem të sistemit endokrin, shikoni se çfarë dëshironi të hani. Ndoshta jo të gjithë ushqimet janë të shëndetshme për ju. Ndryshoni racionin tuaj të ushqimit.
25	Këto ditë mund të bëni një listë me ushqime të përshtatshme. Shihni reagimin për çdo ushqim që merrni. Nëse ju pëlqen ushqimi i caktuar - ju përshtatet, përndryshe mos e merrni atë. Në përgjithësi, preferoni ushqimin delikat. Lejohet agjërimi i thatë. Shmangni mishin dhe alkoolin.
26	Lejohet ushqimi pikant dhe ai i mishit. Mund të përdorni erëza si xhenxhefil, spec djegës, hudhër, mustardë, etj.
27	Ushqimi delikat, substancial, siç është raguja e perimeve, sallatat, perimet e ziera preferohen. Çaji bimor qetësues mund të sjellë një efekt të favorshëm. Përdorni melissa, kamomil dhe nenexhik. Bëni një brumë buke për bukë dhe kek.
28	Jini veçanërisht të kujdesshëm me ushqimin sepse kjo ditë simbolizon fillimin e tretjes dhe transformimit të ushqimit që merrni. Kjo është dita e vetme kur ushqimi digjet dhe shndërrohet plotësisht në inde. Ndiqni instinktin tuaj kur zgjidhni ushqimin. Yogi zakonisht bëjnë të njëjtën gjë - blini shumë ushqime të ndryshme dhe hani atë që dëshirojnë. Mos e teproni, jini të kënaqur. Qumështi dhe gjiza janë ushqimi më i mirë këtë ditë. Frutat dhe mjalti preferohen. Mos agjëroni, shmangni mishin, arrat, lakrën e fermentuar, miellin, kokrrat, farat, ushqimet e forta dhe alkoolin.
29	Këtë ditë elementët e ujit janë aktivë, kryesisht kujdesen për veshkat tuaja. Birra, shumë ujë, qumësht ose prodhime të qumështit mund të jenë të dëmshme. Shmangni çdo procedurë pastrimi.
30	Produktet kryesore për të shmangur këtë ditë janë mishi i shpendëve, veçanërisht mish i pulës dhe vezët. Hani më shumë fruta - mollë, hurma, qersh, kajsi. Pini verë dhe çaj bimor (çaji i zi nuk rekomandohet).
31	Këtë ditë mund të agjëroni ose të mbani një dietë vegjetariane. Nëse nuk jeni vegjetarian hani ushqime delikate, drithëra dhe peshk. Shmangni nikotinën dhe alkoolin.

Kredi Agrobiznes 

A mund të blej makineri dhe
pajisje të reja bujqësore?

*SIGURISHT,
BËHET!*



 **CREDINS bank**

www.bankacredins.com

Tel.: +355 4 53 53 000

